

III Radionice za više razrede srednje škole (albanski)

III Punëtoritë për klasët e larta të shkollave të mesme

1 Identiteti dhe përkatësia

- 1.1a Identiteti im kulturorë
- 1.1b Identiteti kulturorë i bashkësisë sime

2 Ngjashmëritë dhe dallimet

- 2.1 Burimet e dallimeve dhe ngjashmërive/ „*Ti je ti dhe unë jam unë*“
- 2.2 Dallimet individuale dhe grupe / „*Shkojmë për t'u larë*“

3 Diskriminimi dhe barazia

- 3.1 Kush i krijon vlerat e shoqërisë sonë? / „*Përparimi madh*“
- 3.2a Stereotipet dhe paragjykimet / „*Tri ngjyrat e kulturës*“
- 3.2b Tejkalmi i paragjytimeve / „*Tri ngjyrat e kulturës*“
- 3.3 Seksi dhe gjinia / „*Misioni planeti Tokë*“
- 3.4 Konstruksioni social i roleve gjinore
- 3.5 Diskriminimi / „*Shumica dhe pakica*“
- 3.6 Takimi i grupit të shumicës me ate të pakicës – përvojat pozitive
- 3.7 Mundësitë e pabarabarta / „*Luaj vendit dhe bëj diçka*“

4 Të drejtat e njeriut dhe sjejlja me përgjegjësi

- 4.1 Nga aspekti medial: Kush flet për të drejtat e njeriut?
- 4.2 Zgjedhjet tona të stileve jetësore ndikojnë tek njerëzit tjerë

5 Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve

- 5.1 Kompetenca interkulturore
- 5.2 Multiperspektiva / „*Vizita e parë në kulturën Albatros*“
- 5.3 Katër reagime në takimin e kulturave të ndryshme
- 5.4 Decentrimi / „*Vizita e dytë në kulturën Albatros*“
- 5.5 Dialogu interkulturorë

1 Identiteti dhe përkatësia

1.1a Identiteti im kulturorë

<i>Burimi</i>	<i>Arsimimi dhe mirëkuptimi interkulturorë - Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologjia, Edukimi qytetar; Kushtetuta dhe e drejta civile ; Ora e bashkësisë klasore
Materiali	Poster me definicionin dhe shenime mbi identitetin, letër A4, lapsa dhe flomaster, FC dhe markerë dhe RM i shumëzuar
Qëllimi	Të vetëdijësohemi, që njëkohësisht kemi një numër të madh identitetesh (dhe rolesh), të përshkruhen dhe të jenë të ndryshueshëm.

Hapat

1. Përjetimi i identitetit (15')

Udhëheqësi/ja paraqet termin identitet dhe sqaron, që secili person posedon identitet të shumëfishtë, megjësisht që njëkohësisht ka disa identitete/role të ndryshme (sipas Tekstit mbi identitetin). Gjithashtu, njerëzit identitetin e përjetojnë në mënyra të ndryshme – dallohen sipas asaj cilit nga identitetet e veta i kushtojnë rëndësi më të vogël, gjegjësisht më të madh.

Detyra e çdo nxënësi/e është, që të ndajë tre identitete të tijat, të cilat i konsideron si më të rëndësishëm në këtë periudhë të jetës së tij dhe t'i shkruaj në letër.

Udhëheqësi/ja në FC shënon shpeshësinë(frenkuencën) e paraqitjes së disa llojeve të identitetit (psh. Familjarë, profesional, seksorë/gjinorë, etnik, e grupëmohave...)dhe hap një diskutim të shkurtër me temë përse për dikend disa identitete janë më pak e disa më shumë të rëndësishëm.

2. Identiteti im kulturorë (35')

Udhëheqësi/ja tregon , se identitetit të një personi gjatë komunikimit me pjesëtarët e bashkësisë së tij i jepet forma gjatë interaksionit, kurse me pjesëtarët e kulturave tjera gjatë kontakteve dhe se tash do të merren me atë, se si e shohin identitetin e tyre kulturorë dhe ndikimet e ndryshme, të cilat kanë kontribuar në ndërtimin e identitetit personal.

Detyra e nxënësve/eve është, që duke shfrytëzuar simbole, forma dhe ngjyra të ndryshme, të vizatojnë në letër identitetin e tyre kulturorë – prej çkahit përbëhet identiteti kulturorë, gjegjësisht si e shohin përmbajtjen e tij. Më pas, duhet të tregojnë, si i shohin ndikimet e ndryshme, të cilat kanë kontribuar për formulimin dhe tij. Për paraqitjen e intensitetit dhe kahjeve, mund të përdoren shigjetat e trashësisë dhe orientimit të ndryshëm.

Kur mbaron vizatimi udhëheqësi/ja u thotë nxënësve/eve, që orën vijuese do të vazhdojnë punën me vizatimet (të shihet punëtorja 1.1b). Nëse mbetet kohë, paraqitet “ekspozita e identiteteve” (të cilën nxënësit/et, sipas vullnetit të lirë e vizitojnë dhe shikojnë).

IDENTITETI

- Identiteti paraqet vetëdijen lidhur me atë, se në situata dhe kohëra të ndryshme jemi personi i njejtë, personaliteti identifikues.
- Kur flasim për identitetin, në të vërtetë i përgjigjemi pyetjes "**Kush jam unë**".
- **Identiteti personal** përfshin përjetimin e trupit dhe pamjes tënde fizike (Uni fizik), vlerësimin personal për vetitë psiqike (Uni psikologjik) si dhe vetitë e dëshiruara (Uni ideal).
- **Identiteti social** ka të bëjë me ndjenjën, që ka personi për statusin e vet personal. Ky identitet përfshinë ndjenjën e përkatësisë në ndonjë grup të caktuar, si dhe vetëdijen për pozitën personale dhe rolet në ato grupe.
- Secili prej nesh i takon grupeve të ndryshme, e me vetë këtë posedon një sërë identitetesh të ndryshme sociale, siç janë: identiteti familjarë, identiteti profesional, identiteti gjinorë, identiteti seksual, identiteti kulturorë, identiteti klasorë, identiteti nacional etj.
- Përjetimi jonë i identitetit, është formuar në bazë të këtyre llojeve të ndryshme të identitetit. Për këtë arsye thuhet, se secili person posedon identitetet multipël, megjësisht identitetet të shumfishtë.
- Njerëzit në mes vete dallohen, sipas asaj se cilit nga identitetet e veta i kushton më tepër rëndësi e cilit më pak. Gjithashtu, përjetimi i identitetit ndryshon gjatë rritjes.
- Mendohet, se adoleshenca është periudhë e krizës së identitetit, sepse atëherë analizohet identiteti personal dhe vlerat e adoptuara paraprakisht. Personat, të cilët me sukses e kanë tejkaluar këtë krizë identiteti, më vonë mirë i përshtaten rolit të vet profesional, bashkëshortorë dhe prindërorë.

NEVOJA QË T'I PËRKASË NJË GRUPI

- Tek njerëzit ekziston nevojë intensive që t'i përkasin një grupi, posaçërisht në familje, e shpesh edhe një grupi profesional, nacional, por edhe grupeve tjera. Për këtë arsye është me rëndësi një pjesë e identitetit social dhe shkalla e lidhshmërisë me grupet e caktuara.

1.1b Identiteti kulturorë i bashkësisë sime

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturorë - Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Edukata qytetare; Kushtetuta dhe e drejta qytetare; Ora e kujdestarisë, Histori, Letërsi, Gjeografi, Matematikë , Art
Materiali shumëzuar	Poster me modelin e bregut të akullt, FC dhe markerë, ngjites letre dhe RM i
Qëllimi	Të konstatohet , se edhe njerëzit tjerë, të ndryshëm nga ne , njëkohësisht kanë role dhe identitete kulturore të njejta me tonat , si dhe një sërë rolesh dhe identitetesh kulturore të ndryshme. Të tregohet , që disa ndikime të veçanta kulturore janë më pak e disa më shumë të rëndësishëm për formimin e identitetit.

Hapat

Vërejtje : Kjo punëtori është vazhdim i punëtorisë paraprake (të shihet përshkrimi i punëtorisë 1.1a) **Ngjashmëria e identiteteve (15')**

Në hapësirën punuese vendoset „ekspozita e identiteteve tona“ (më së lehti është, që secili nxënës/e ta lëshojë vizatimin e vet në dysheme para vetes, ashtu që të shohë në drejtim të tjerëve). Nxënësve/eve u thuhet të „shetisin“ nëpër hapësirën punuese dhe të gjejnë personin apo personat, të cilët në mënyrë të ngjashme e kanë paraqitur identitetin e tyre. Në grupe të vogla bisedohet rreth përmbajtjes së identitetit kulturorë dhe ndikimeve, që kanë pasur rëndësi për formimin e tij.

2. Kolazh i identiteteve tona (20')

Në mënyrë plenare paraqiten konkluzionet, deri tek të cilat është ardhur gjatë bisedës në grupe të vogla, në FC (apo tabelë) shkruhen ndikimet e ndryshme, që kanë pasur rëndësi dominante për formimin e identiteteve kulturore. Në fund, nga të gjitha vizatimet bëhet një kolazh (varet në mur apo vendoset në dysheme).

3. Modeli i bregut të akullt (10')

Udhëheqësi/ja shkurtimisht definon kulturën:

“**Kultura** është grumbull formash distinktive, shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të **ndonjë shoqërie apo grupi njerëzish**, së bashku me artin, letërsinë, stilet jetësore, mënyrat e jetesës së përbashkët, sistemit të vlerave, traditave dhe besimit të tyre“. (UNESCO, 2001)

Udhëheqësi/ja tregon, se Modeli i bregut të akullt (të shihet materiali i dhënë punues), një nga modelet që përdoret më shpesh për sqarimin e kompleksitetit të ndikimit të kulturës. Analogjia e bregut të akullt, shfrytëzohet për të treguar cilësitë dalluese të fshehura dhe të padukshme nga jashtë dhe elementet e kulturës. Supozimet, normat dhe vlerat kulturore, të cilat e formulojnë identitetin dhe sjelljen e njerëzve në një kulturë janë të heshtura, gjegjësisht të vendosura në atë pjesë të bregut të akullt, i cili ndodhet nën ujë. Vetëm një pjesë e vogël e ndikimeve kulturore (siç janë rregullat e shkruara) janë të dukshme, gjegjësisht gjenden „mbi sipërfaqen e ujit“. Të gjitha ndikimet kulturore të dukshme dhe elementet e kulturës janë shprehje e ndikimeve të fshehura dhe elem! enteve, të cilat gjenden në bazën e tyre. Ky model në mënyrë të ilustruar na tregon, përse në disa momente është e vështirë të kuptohen njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore – sepse jemi të drejtuar në pjesët e dukshme të „bregut të tyre të akullt“, dhe nuk kemi mundësi të vërejmë menjëherë në çka janë të bazuara ato.

Alternativa (nëse premtion koha) – Nxënësit/et, të ndarë në grupe të vogla, marrin karakteristikat e shkruara në letër dhe kanë për detyrë t'i klasifikojnë sipas asaj, cilat janë të dukshme e cilat të padukshme.


IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit /et individualisht gjurmojnë dhe përgatisin prezantime të shkurtëra të kulturave, të cilat kanë pasur ndikim të rëndësishëm në formimin e identitetit të tyre.
- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar bëjnë një hartë, me anë të së cilës e tregojnë përbërjen multietnike (të dikurshme dhe të tashme) të bashkësisë lokale dhe hapsirat gjeografike (kontinentet, shtetet, rajonet) prej nga rrjedhin grupet etnike të veçanta (orët e gjeografisë).
- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar apo individualisht shkruajnë ese lidhur me ndonjë aspekt apo zhvillim jetësor të bashkësisë lokale të fokusuar në persona të rëndësishëm (meshkuj dhe femra), vende dhe ngjarje (zgjedhin lëndët).
- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar realizojnë intervju me personat, që llogariten „kronik lokal”, e më pas shkruajnë artikull gazetaresk të shkurtë lidhur me ndonjë ngjarje që ka të bëjë me të kaluarën e bashkësisë lokale, ngjarje kjo që ka sjellur risi të rëndësishme apo ka ndryshuar ndonjë aspekt jetësorë të bashkësisë lokale (orët e historisë).
- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar shkruajnë raport lidhur me ndonjë aspekt ekonomik, politik dhe të zhvillimit social të bashkësisë lokale (në bashkëpunim me mentorin), duke shfrytëzuar të dhënat numerike dhe pasqyrat tabelare e grafike të trendeve (orët e shkencave shoqërore dhe matematikës).
- Nxënësit/et së bashku imagjinojnë dhe realizojnë anketë me banorët e bashkësisë lokale lidhur me anët „pozitive dhe negative” të jetës së përbashkët „(në bashkëpunim me mentorin) dhe rezultatet u’a paraqesin moshatarëve (orët e shkencave shoqërore).
- Nxënësit në mënyrë të organizuar vizatojnë (apo u shkruajnë propozim arsimtarëve, drejtorit të shkollës etj), si duhet të duket një shkollë ideale multietnike, apo si mund të bëhet shkolla e tyre më e mirë (aktivitet jashtëshkollorë apo një projekt i vogël shkollorë/shiko foton poshtë).
- Nxënësit në mënyrë të organizuar bëjnë një pano shkollore apo imagjinojnë një shfaqje shkollore me emrin Bashkësia multietnike –shtëpia ime!

MODELI I BREGUT TË AKULLT

ELEMENTET E DUKSHME TË KULTURËS

Arti figurativ **letërsia**
teatri **muzika klasike** folklori
muzika e popullarizuar **sporti** kuzhina **veshëmbathja**



ELEMENTET E PADUKSHME TË KULTURËS

domethënia e thjeshtësisë të **kuptuarit (nocioni)** e **bukurisë** idelaet primare për përkujdesjen ndaj fëmijëve
kosmologjija rregullat e përshtatshmërisë(hijeshisë) **raporti ndaj kafshëve** definicioni i mëkatit
praktika gjyqësore **modelet e raporteve mbirenduese dhe nënrenduese** kuptimi i drejtësisë
motive për punë idetë për të udhëhequr **tempoja e punës** modelet e vendosjes në grup
kuptimi i pastërtisë **qëndrimet mbi varshmërinë** teoritë mbi sëmundjet **kontakti me sy**
rolet që kanë të bëjnë me moshën, seksin, përkatësinë klasore, profesionin, farenfisninë **natyra e shoqërisë**
kuptimi i „unit tënd“ **modelet e të vërejturit vizuel** qasjet në zgjidhjen e problemeve **gjuha e trupit** të
kuptuarit e lëvizshmërisë statusore **definicioni i marrëzisë** ekspresioni facial **të kuptuarit e logjikës dhe**
korrektësisë organizimi i kohës **mënyra si të sillesh me ndjenjat** interaksioni social format komunikative
në kontekste të ndryshme **idetë mbi adoleshencën**
kuptimi i së kaluarës/ardhmërisë prirja për gara/bashkëpunim rregullimi i hapësirës fizike

2 Ngjashmëritë dhe dallimet

2.1 Burimet e dallimeve dhe ngjashmërive/ „Ti je ti dhe unë jam unë“

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturore - Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologjia, Kushtetuta dhe e drejta qytetare, Sociologjia, Edukata qytetare, Ora e kujdestarisë
Materiali	-
Qëllimi	Që nxënësit/et të vërejnë ngjashmëritë dhe dallimet në mes tyre, të shijojnë çfarë është ndjenja të jesh pjesëtarë i shumicës/pakicës dhe të shohin burime të llojllojshme të dallimeve.

Hapat

1. Ushtrimi hyrës (15') – Nxënësit qëndrojnë në rreth, deri sa udhëheqësi/a u lexon thënie të ndryshme (të shihet lista e thënieve). Pas leximit të çdo thënie, ata nxënës/e për të cilët kjo thënie është e vërtetë lëshojnë rrethin dhe hyjnë në mes, kurse të tjerët mbeten aty ku janë.

Vërejtje të rëndësishme: a) pjesëmarrësve/eve u thuhet, që duhet të bejnë një hap para kur nuk e dëshirojnë këtë për çfarëdo arsye; b) Udhëheqësi/a patjetër merr pjesë në këtë lojë.

Lista e thënieve të mundshme:

- o Unë jam mashkull.
- o Unë jam majtak/majtake.
- o E njoh dikë të një rase tjetër.
- o Kam shokë me prejardhje të ndryshme nga imja.
- o Unë jam vegjetarian/vegjetariane.
- o Gjuha ime amtare është gjuha serbe (hungareze, shqipe, boshnjake etj)
- o Prejardhja ime është shumë nacionale.
- o Nuk jetoj në vendlindje.
- o Së paku një vit kam jetuar jashtë vendit.
- o Kam përvojë personale të diskriminimit, e cilka edhe sot e kësaj dite më dhemb.
- o Kam një anëtarë/e të familjes, që është alkoolist apo narkoman.
- o Kam një anëtarë/e në familje, që është invalid.
- o Unë jam për paqe dhe në mënyrë aktive, i përkrahë aksionet paqësore.
- o Unë rrjedh nga një familje fshatare (e klasës punëtore).
- o Familja ime i përket traditës krishtere (islame, judiste etj).
- o Unë jam besimtar/e aktiv.
- o Unë i dua shtazët dhe merrem me mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- o Në këtë ushtrim shpesh (së paku 5 herë) kam qenë në pakicë.

2. Reflektimi(30')

Udhëheqësi/a pyet pjesëmarrësit : Çka ishte më vështirë për ju në këtë ushtrim? A ka pasur momente kur nuk e keni bërë një hap para e është dashur ta bëni, ose keni bërë hapin e nuk është dashur?

Udhëheqësi/a nxit grupin të kërkojë përgjigje në pyetjen Çka dhe cilët faktorë nga rrethi dhe shoqëria jonë në tërësi i kontribuojnë ekzistimit të dallimeve në mes njerëzve, grupeve dhe bashkësive/shoqërive?

Në fund udhëheqësi/a mledh faktorët kyç: rasën, religjionin, përkatësinë etnike, gjuhën, seksin dhe gjininë, moshën, statusin socio-ekonomik, orientimin vlerësues-politik, orientimin seksual, preferancat psikofizike apo disfunkcionet (shembull. Majtakëria/djathtëria, invaliditeti etj).

2.2 Dallimet grupore dhe individuale/ „Shkojmë për t'u larë“

<i>Burimi</i>	<i>Doracak për zgjidhjen konstruktive të konflikteve – 1 (Grupi MOST, Beograd)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Kushtetuta dhe e drejta qytetare, Sociologji, Edukata qytetare, Letërsi, Histori
Materiali	-
Qëllimi	Që nxënësit/et të shohin dhe shijojnë, se si në disa rrethana specifike, cilido nga dallimet mund të bëhet shkas për „grupim në taborre“ dhe se si brenda secilit grup, përherë ekzistojnë dallimet individuale, ku disa prej tyre mund të jenë më të mëdha se dallimi, i cili ka qenë shkas për krijimin e „taborit“

Hapat

1. Ushtrimi „Shkojmë për të notuar“ (30')

Udhëheqësi/ja së pari paraqet situatën: Njerëzit tentojnë që sipas qasjes së tyre në jetë të ndahen në tri grupe, çka në mënyrë simbolike (metaforike) mund të të krahasohet me mënyrën se si hyjnë në ujë (lumë, liqe, deti) për t'u larë (notuar):

- anëtarët në grupin e parë janë **kërcyes**, ata me vendosmëri i ofrohen ujit (apo shkojnë deri te dërrasa e kërcimeve), kërcëjnë dhe zhyten apo vrapojnë deri te bregu i detit, ku më pas pa u hamendur hidhen në valë duke spërkatur me ujë në të gjitha anët.
- anëtarët në grupin e dytë mund t'i quajmë **shëtitës**, sepse ata hyjnë në ujë njëlloj dhe të unfikuar, nisen me hapa të qetë nga bregdeti dhe thjesht shëtiten në ujë, duke vazhduar ashtu sigurtë, as shpejtë e as ngadalë në drejtim të thellësive.
- ata të grupit të tretë, të cilët në këtë rast mund t'i quajmë **provues**, kur i ofrohen ujit e kanë patjetër që së pari ta provojnë ujin me gishtin e madh të këmbës, e pastaj futen shumë ngadalë dhe në mënyrë graduale dhe lagin trupin e tyre ngadalëdalë, për t'iu përshtatur temperaturës së ujit. Kjo gjë ndonjëherë edhe mund të zgjasë më tepër deri sa të vendosin për të notuar.

Pas kësaj, i lusim nxënësit/et, që së pari të mendojnë pakëz, në cilin nga këto grupe do t'a radhisin veten, që më pas të përcaktohen për njërën nga to (sipas vlerësimit të tyre). Të gjithë ata, që e konsiderojnë veten kërcyes, formojnë një grup të vogël në një anë, ata që veten e konsiderojnë shëtitës në anën tjetër, kurse provuesit formojnë grupin në pjesën e tretë të hapsirës ku ndodhen.

Vërejtje: Nëse ndonjëri nga pjesëmarrësit/et mbetet i papërcaktuar, duhet lutur, që propësepropë, bile për nevojë të kësaj loje, të zgjedhë ndonjërin nga grupet (e më vonë mundet edhe të ndrrojë mendjen).

Në kuadër të secilit grup, nxënësit/et, së bashku definojnë dhe shkruajnë së paku tre virtyte dhe tri të meta të grupit të tyre. Kur mbarojnë së shkruari, përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë vryrtet dhe mangësitë e grupeve të tyre. Është me rëndësi që të gjithë të dëgjojnë me vëmendje njëri tjetrin dhe të mbajnë në mend Çka ka thënë secili grup për veten.

Përsëri të ndarë nëpër grupet e tyre, nxënësit/et definojnë dhe shkruajnë një gjë/veti, që i tërheq më së shumti (u pëlqen) dhe një gjë/veti që i refuzon (nuk u pëlqen) te njëri dhe grupi tjetër, të cilëve nuk u përkasin. Kur mbarojnë së shkruari, përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë çka kanë shkruar për grupet tjera.

Lusim nxënësit që të formojnë një rreth të madh, ashtu që të shihet prej ku deri ku janë kërcyesit, shëtitësit dhe provuesit. Udhëheqësi/ja thotë se në pyetjen vijuese do të përgjigjet secili për vete (dallimet individuale) edhe ate në mënyrë të pazakontë: nëse përgjigja do të jetë „kryesisht jo“ – do të qëndrojë në vend, nëse përgjigja do të jetë „kryesisht po“ – do ta bëjnë një hap kah qendra e rrethit, e nëse përgjigja do të jetë „Po shumë“ – do t'i lëvizin dy hapa kah qendra e rrethit. Pas kësaj udhëheqësi/ja shtron pyetjen: A keni dëshirë të notoni (laheni) gjatë dhe të qëndroni në ujë deri sa të gjithë shokët/qet tuaj të dalin pre ujit?.

Kur nxënësit/et përgjigjen (qëndrojnë në vend, bëjnë një apo dy hapa), fitohen tre rrathë koncentrik dhe me këtë formohen tri grupe të reja, nga të cilat secila do të ketë përbërje të përzier në krahasim me ndarjen paraprake (kërcyes, shëtitës, provues). Secili grup duhet vetë të mendojë dhe t'i jep vetes një emër të ri.

2. Reflektimi (15')

Udhëheqësi/ja, së pari lut nxënësit/et të mendojnë pak për gjithëçka që përjetuan pak më parë dhe t'i veçojnë ato çaste apo fenomene, që u kanë lënë më shumë përshtypje.

Udhëheqësi/ja shtron disa pyetje lidhur me këtë ushtrim:

- # Cilat situata jetësore u'a përkujton kjo gjë?
- # A keni përjetuar ndonjëherë në realitet, që ndonjë dallim, të cilit deri atëherë nuk i keni kushtuar kujdes, përnjëherë të bëhet arsye për grupime, bile edhe armiqësi?
- # Çka keni mësuar (fituar) nga ky ushtrim?

Udhëheqësi/ja përmbledh të gjitha vërejtjet dhe konkluzionet e nxënësve/eve. Nëse paraqitet nevoja, shton edhe konkluzionin e vet:

Në jetën e përditëshme shpesh bëjmë atë, që ka qenë instruksion i parë në këtë ushtrim. Tentojmë që veten dhe të tjerët t'i radhisim në kategori të caktuara, të cilave pastaj u japim vlera të caktuara dhe i vlerësojmë në bazë të masave të caktuara. Këtë e bëjmë ne, këtë e bëjnë të gjithë. Këto vlerësime ndikojnë në sjelljen tonë dhe mund të shpengojnë në situata të caktuara të rëndësishme për ne.

IDE PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et në grup apo individualisht kërkojnë dhe përgatisin një rrëfim të shkurtër të ndonjë ngjarjeje – reale (psh. Në historinë e re vendore apo botërore) apo fiktive (psh. Në ndonjë roman, film etj)- e cila ilustron përvojën të cilën e kanë përjetuar gjatë ushtrimit, kur cilido dallim mund të bëhet shkas për „grupim në taborre” dhe armiqësi eventuale (orët e historisë, letërsisë, sociologjisë etj).

3 Diskriminimi dhe barazia

3.1 Kush i krijon vlerat e shoqërisë sonë? / „Një hap i madh para“

Burimi	<i>Changing Perspectives, Cultural values, Diversity and Equality in Ireland and the Eider World, (2002), A Resource for Civic, social and Political Education, Dublin</i>
Kohëzgjatja	90 minuta (2 orë mësimi)
Lënda	Psikologji, Edukatë qytetare; Kushtetuta dhe e drejta qytetare; Ora e bahskësisë së klasës
Materiali	RM, lapsa dhe flomasterë, FC dhe markerë
Qëllimi	Të vetëdijësohet mënyra e të shprehurit të vlerave kulturore në shoqëri në rrethanat, në të cilat disa grupe trajtohen pozitivisht apo përmbahen më tepër se sa tjerat. Vetëdija për jobarabarësinë në shoqërinë tonë, mirëkuptimi se si zgjedhjet në lëminë e veprimit politik janë të bazuara në vlerat kulturore.

Hapat

Hapat e mëdhenj drejt barazisë – ora e parë

Përgatitja – Për realizimin e kësaj punëtorie nevojitet hapësirë e madhe (koridori i shkollës apo ndonjë sallë e madhe). Nëse aktiviteti zhvillohet në klasë, duhet të largohen të gjitha bankat dhe karriget dhe të bëhet qasje sipas instruksioneve alternative. Kartelat me identitete të ndryshme (8 lloje kartelash) të shumëzohen, ashtu që secili nga nxënësit/et të merr një identitet (kartelë) dhe anët e pasme të kartelave me identitet të njejtë të dallohen nga njëra tjetra (psh. 8 ngjyra për 8 tipe të identiteteve/kartelave), çka do t'i mundësojë udhëheqësit/es, që më lehtë të shohë cilin identitet e ka marrë secili nga nxënësit/et.

1. „Të bëjmë një hap para apo jo“ – ushtrim (15')

Udhëheqësi/ja fton nxënësit/et të radhiten në një rend në fund të sallës, e pastaj secilit prej tyre u jep nga një kartelë dhe në atë mënyrë atyre u ndan një identitet të ri (shiko materialin punues). nga nxënësit/et kërkohet, që askujt të mos i'a tregojnë kartelat e veta dhe që secili prej tyre të mendojë për identitetin e vet të ri dhe për atë se si duket jeta e tyre.

Udhëheqësi/ja thotë se do të lexojë disa pohime / deklarata lidhur me atë se si jetojnë njerëzit, kurse detyra e pjesëmarrësve është, që pas dëgjimit me kujdes të secilit pohim veç e veç (nëse është e nevojshme pohimi mund të lexohet sërish) të:

- në rast se mund ta bëjnë lehtë atë çka thuhet në pohim, të bëjnë një hap të madh përpara (një hap të gjatë)
- nëse këtë mund ta bëjnë, por me vështirësi, duhet të bëjnë një hap të vogël përpara.
- në rast se assesi nuk mund të bëjnë atë çka thuhet në pohimin e lexuar, qëndrojnë aty ku janë, d.m.th. nuk lëvizin vendit.

Udhëheqësi/ja ngadalë lexon pohimet njërin pas tjetrit, duke lënë kështu hapësirë dhe kohë të mjaftueshme, që nxënësit/et të mendojnë për pohimin dhe të bëjnë një hap përpara në pajtueshmëri. Pas çdo pohimi, nxënësit/et mbeten ku janë takuar (nuk kthehen në poyitat e mëparshme). Kur të mbarojnë, nxënësit/et do të gjenden në vende të ndryshme të hapësirës, sepse disa prej tyre nuk kanë lëvizur apo kanë lëvizur shumë pak, kurse të tjerët kanë arritur shumë larg.

Instruksioni alternativ për mbajtjen e ushtrimit në klasë: udhëheqësi/ja u ndan nxënësve/eve kartelat me identitete. Formohen grupe të vogla (8 grupe për 8 identitete) dhe secili grup duhet të ketë një vullnetarë/e. Vullnetarët/et luajnë në ushtrim siç është përshkruar, kurse pjesa tjetër e nxënësve në klasë shiqojnë. Nga vrojtuesit kërkohet, që të dëgjojnë me kujdes dhe të vendosin a do të lëviynin apo jo, sikur të ishin në vendin e vullnetarëve/eve.

2. Diskutimi dhe reflektimi(35')

Udhëheqësi/ja kërkon nga nxënësit/et (të cilët tani janë të ulur në rreth), të përkujtojnë ku kanë qenë në fund të aktivitetit parapra dhe pas kësaj u shtron pyetjet:

- Kush ka pasur mundësi t'i bëjë hapat(lëvizjet) më të mëdha?
- Kush ka mundur të bëjë, vetëm hapa të vegjël?
- Cili nuk ka mundur të lëvizë fare prej vendi?
- Kujt i është paraqitur ndjenja , se ka mundur të bëjë hapa vetëm disa herë?
- Si e keni ndjerë veten kur të tjerët kanë lëvizur me tempo më të shpejtë/ngadalshëm se ju?
- Cilat kanë qenë pengesat kryesore, në të cilat kanë hasur ata që kanë mundur të lëvizin vetëm pak?
- Prej nga, sipas mendimit tuaj, dallim aq i madh në aspektin e largësisë deri ku mund të shkojnë njerëzit?
- Çka ju flet për barazinë apo mungesën e barazisë në shoqëri?

Nxënësit/et komentojnë apo përgjigjen në pyetjet, duke treguar së pari cilin identitet e kanë pasur, ashtu që klasa fillon të shohë, se cili identitet i inkurajon nxënësit të lëvizin, e cili i pengon. pasi që ndonjëri prej tyre mund të ketë ndjenja të forta lidhur me faktin se nuk mund të lëvizin, duhet përkujtuar nxënësve të dëgjojnë njëri tjetrin kur përshkruajnë ndjenjat dhe mendimet e tyre (shembull: " Kujtohuni, që Slavica nuk ka mundur aspak të lëvizë nga vendi, pasi që nuk mundet të dëgjojë instruksionin").

3. Detyrë shtëpie - udhëheqësi/ja kërkon nga nxënësit/et të shkruajnë një shënim të shkurtë lidhur me ate, se si janë ndier gjatë ushtrimit dhe çka kanë mësuar për gjendjen në të cilën gjendet personi identitetin, etë cilit e kanë pasur. është e mundur, që nxënësit të mos kenë njohuri të mjaftueshme për disa persona apo situata, për t'i përshkruar plotësisht. Udhëheqësi/ja u ndihmon rreth burimeve informuese, të cilët u duhen para orës në vijim.

Një hap i madh përpara drejt barazisë – ora e dytë

4. Të menduarit mbi situatën 8 të identitetit (30')

Udhëheqësi/ja kërkon nga nxënësit/et të formojnë një grup me ata, të cilët kanë pasur identitetin e njejtë në ushtrimin „një hap përpara apo jo“?. Pas kësaj, të gjithëve u ndan kopje të Listës së deklaratave (thënieve) (të shihet materiali punues). Nga nxënësit/et kërkohet, që të bisedojnë për shkaqet, për të cilat kanë lëvizur apo nuk kanë lëvizur vendit, duke sqaruar për secilin pohim dhe për ate, se se si e kuptojnë situatën, në të cilën ndodhet grupi i identitetit të tyre. Është e kuptueshme, që ekzistojnë dallime në të kuptuarit e situatës, kështu që është me rëndësi të arrihet qëllimi, që të jenë të hapur për të dëgjuar qëndrime të ndryshme. (shembull: Grupi „Jovan“ do të duhej të mendonte për raportin e tyre! me disa nga grupet tjera, të cilët nuk kanë pasur mundësi të lëvizin apo kanë lëvizur fare pak).

Udhëheqësi/ja u'a përkujton nxënësve/eve, që situatat me të cilat janë marrë nuk kanë ndodhur rastësisht. Ato janë pasojë e politikës sociale ekonomike, të cilën e udhëheqin politikanët apo nga qëndrimet e përgjithëshme që mbretërojnë në shoqëri. Kjo don të thotë, që këto situata mund të ndryshohen, nëse ekziston gatitshmëria dhe dëshira, që gjërat të shkojnë përpara. Udhëheqësi/ja u jep nxënësve/eve listën punuese Hapat e mëdhenj përpara (të shihet materiali punues) dhe kërkon që ta plotësojnë në grupet e tyre.

5. Një hap përpara drejt barazisë – informatë kthyesë (15')

Secili grup paraqet një nga përgjigjet e veta, kurse udhëheqësi/ja nënvizon problemin kryesorë që është paraqitur dhe kërkon lidhje të përbashkëta, të cilat do të mund t'i shpënin nxënësit/et deri te zhvillimi i projektit në lëminë, në të cilën punohet.

IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit/et në së bashku apo individualisht bëjnë një pano përkrahëse, duke ngjitur në një letër

të madhe kartelat me identitete të ndryshme. Koleksionit ekzistues të kartelave, i shtojnë kartela të reja me identitete, të cilat i konsiderojnë të rëndësishëm për realizimin e përkrahjes së atyre që kanë nevojë. Identitetet e ndryshme i lidhin mes vete me anë të shigjetave, të cilat me kahjen e tyre shënojnë kush kujt mundet t'i ofrojë përkrahje, ndërsa nën secilën shigjetë qëndron një përshkrim i shkurtër i përkrahjes.

Materiali punues

KARTA ME IDENTITETE

Quhem Jovan. I kam 40 vjet dhe jam drejtor i një firme të njohur në kryeqytet.	Quhem Egon. I kam 25 vjet dhe jam recepcionist. Lëviz me ndihmën e karrocës
Quhem Kata. I kam 82 vjet dhe jetoj vetëm.	Quhem Esmë. I kam 30 vjet. Jam rome dhe refugjate nga Kosova.
Quhem Adem. I kam 50 vjet dhe jam i papunë. jetoj në afërsi të një qyteti të vogël.	Quhem Slavica. I kam 21 vjet dhe jam studente. Jam plotësisht e shurdhër dhe mirrem vesh me anë të shenjave.
Quhem Suzana. I kam 19 vjet. Jam rrobaqepëse.	Quhem Vasil. I kam 23 vjet. Jam automekanik.

LISTË DEKLARATASH

- Falë punëve të ndryshme, që i kam bërë, unë kam një jetë të pasur shoqërore.
- Nuk kam problem t'i vizitoj shokët dhe familjarët kur të dua unë.
- Më pëlqen të blej dhe nuk e kam të vështirë të shkoj nëpër dyqanet më të mira.
- Kulturës sime i japin rëndësi trupat dhe strukturat e nivelit shtetërorë.
- Fëmijët e mi shumë lehtë mund të regjistrohen në shkollën, që duan.
- Mendoj, që kam gjasa të njejta, si çdokush tjetër për të gjetur punë apo të përparoj në punën, për të cilën jam e kualifikuar.
- Nuk e besoj, se ndonjë polic pa ndonjë arsye, do të më ndalonte në rrugë për të më marrë në pyetje.
- Mund të jetoj një jetë të pavarur.
- Nuk i frikësohem sëmundjes. E di, se shumë lehtë mund të marr ndihmën e duhur mjekësore.
- Në vende publike ndjehem mirë.
- Pa kufizime të mëdha financiare, mund të jetoj në një banesë që më pëlqen mua.

LISTA E PUNËS – HAP I MADH

Mendoni për diskutimin që sapo e zhvilluat, e pastaj së bashku me anëtarët e tjerë të grupit tuaj plotësoni këtë tabelë. Në fillim të tabelës është dhënë një shembull.

Çka nuk mund të bëj unë?	Përse?	Si mund të ndryshojë shoqëria për të ma mundësuar këtë?
<i>Kata: Nuk e kam të lehtë të shkoj në dyqanet më të mira</i>	<i>Qarkullimi me autobus është mjaft i dobët, e unë nuk kam veturë</i>	<i>Pushteti lokal mund të sjellë vendim për të investuar më shumë për qarkullimin publik.</i>

3.2a Stereotipët dhe paragjykimet / „Tri ngjyrat e kulturës“

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturorë – Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta (simulacioni traje oko 25 minuta, a onda sledi refleksija)
Lënda(ët)	Psikologji, Kushtetuta dhe e drejta qytetare, Sociologji, Edukatë qytetare, Ora e kujdestarit të klasës
Materiali	Letër A4, lapsa dhe RM i shumëzuar
Qëllimi	Kuptimi i arsyes dhe mënyrës së lindjes së stereotipeve, paragjykimeve, kuptimi i mekanizmave të veprimit të tyre në sjelljen dhe pasojat, deri te të cilat shpien.

Hapat

1. Hyrje - Situata e mundshme (për nevoja simuluese) – Me rastin e shënimit të ditës së „të drejtave të njeriut“, delegacionet e nxënësve/eve nga të gjitha vendet e botës, i janë përgjigjur ftesës për të marrë pjesë në Konferencën botërore të të rinjëve. Menjëherë pas arritjes, ju presin oragnizatorët e konferencës dhe ju drejtojnë në sallën e hotelit, që të takoheni edhe me dy delegacione, me të cilat do të duhej të bashkëpunoni intensivisht gjatë konferencës.

Nxënësit/et marrin instruksionin e përgjithshëm dhe ndahen në tri grupe të vogla.

2. Detyrë për pjesëmarrësit/et

Në kuadër të grupeve të vogla nxënësit/et, së pari duhet të mësojnë dhe diskutojnë karakteristikat e kulturës, të cilën e kanë marrë për të simuluar (e gjelbërta, e kaltërta apo e kuqja), e më pas edhe karakteristikat e dy kulturave tjera.

Në hapin e dytë, secili grup i vogël („kulturë“) duhet të mirret vesh dhe të shkruajë

- Çka mendojnë për dy kulturat tjera? – Çfarë janë njëra palë, e çfarë pala tjetër? Çka mund të pritet nga ata?
- Çka mendojnë, çfarë mendimi ka për ta secila nga kulturat?- Si i shohin njëra e si pala tjetër?

3. Ndërrimi

Fillohet nga njëra kulturë (psh e kaltërta), ashtu që së pari dy kulturat tjera lexojnë çka mendojnë për të, e më pas ajo lexon çka ka menduar ajo se do të mendojnë për të. E njëjta gjë përsëritet edhe me dy kulturat tjera.

4. Reflektimi

Në grupin e madh nxënësit/et tregojnë cilat fenomene i kanë vërejtur, kurse udhëheqësi/ja i shënon në FC apo tabelë. Nëse nuk e përmendin këtë, udhëheqësi/ja i pyet: A ka pasur ndonjë thënie të pavërtetë dhe të pakuptimtë për ta? A i ka "ofenduar" ndonjë deklaratë dhe përse?

Në fund udhëheqësi/ja shpërndan Tekstin mbi stereotipet dhe paragjykimet dhe sqaron mekanizmin e veprimit të tyre.

IDE PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar gjurmojnë dhe përgatisin prezantime të pasqyrave stereotipe mbi pjesëtarët/et e grupeve dhe kulturave të ndryshme.
- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar apo individualisht gjurmojnë „përmbledhjen e barçoletave“ dhe përgatisin prezantimin e barçoletave, të cilat përmbajnë paragjykime mbi disa grupe apo kultura, e në të cilat e argumentojnë paskatësinë e tyre.

Teksti

STEREOTIPËT DHE PARAGJYKIMET

Secili prej nesh, njëkohësisht i përket një numri të madh të grupeve të ndryshme, të cilat jo vetëm që na japin role të ndryshme dhe na përcaktojnë se si të sillemi në situata të ndryshme, por edhe na caktojnë se si do ta shohim veten.

Qëndrimet ndaj njerëzve apo grupacioneve tjerashpesh i adoptojmë pavetëdije. Në personat e moshës më të re ndikojnë qëndrimet e anëtarëve të familjes së ngushtë, e më vonë edhe moshatarët e tyre. Opinioni për njerëzit tjerë formohet edhe nën ndikimin e porosive, që i dërgojnë mas-mediat.

Fëmijët mund të fillojnë shumë herët t'i largojnë dhe nënçmojnë personat që dallohen nga ata sipas seksit, aftësive, traditave, kulturës dhe racës. Të rriturit, por edhe fëmijët shpesh sjellin përfundime mbi personat dhe grupet tjera të njerëzve ende pa i njohur vërtetë, në bazë të të dhënave jotëplota e shpesh edhe të paskta.

Stereotipet – opinionet e thjeshtëzuara dhe gjeneralizimet e një grupi të caktuar njerëzish, me supozime, që të gjithë pjesëtarët e atij grupi kanë karakteristika të përcaktuara (stereotipet kryesisht janë negative, por mund të jenë edhe pozitive).

Paragjykimet – ndjenjat dhe qëndrimet negative ndaj një grupi apo individi, nuk janë të bazuara në njohuritë kuptueshme dhe të balancuara dhe përvojën me atë individ apo grup.

Diskriminimi – veprim i ndryshëm ndaj individit apo grupit nga veprimi ndaj të tjerëve, i bazuar në kuptimin apo opinionin personal (kryesisht negativ, por mund të jetë edhe pozitiv).

Pikërisht për shkak të gjithë kësaj, konfliktet janë dukuri që paraqitet shpesh, si në mesin e anëtarëve të të njejtit grup, poashtu edhe në mesin e grupeve të ndryshme. Sa më e madhe të jetë vetëdija mbi dallimet (njohja dhe mirëkuptimi i dallimeve), aq më e madhe do të jetë toleranca ndaj dallimeve tek anëtarët e ndonjë grupi.

Materiali punues

Kultura e Gjelbërt

Vlerat, bindjet dhe qëndrimet

Shumica e anëtarëve të bashkësisë suaj me të vërtetë është religjioze.
Vendimet i sillni me koncensus, të cilit i paraprin diskutimi i holësishëm.

Karakteristikat joverbale të stilit tuaj të komunikimit

Kur bisedoni me njerëz të panjohur, mos e praktikoni shikimin drejt në sy, në mënyrë që me këtë mos t'i pengoni ata.
Gjatë bisedës u konvenon largësia e butë nga bashkëbiseduesi (1 m).

Karakteristikat verbale të stilit komunikues

Kur shqyrtoni diçka, i shmangeni kundërshtimit të drejtpërdrejtë.
Heshtja gjatë bisedës, tregon rrjedhën pozitive dhe konstruktive të tij.

Normat dhe taridat e sjelljeve në punë

Meshkujt janë më të „ngjirur“ dhe më analitikë se sa femrat, kështu që sillen në përputhje me këtë.
Në situata të punës është zakon, që meshkujt dhe femrat të rrijnë në grupe, gjegjësisht ndarazi.

Përsëhendetjet dhe stili i të paraqiturit

U drejtoheni të tjerëve me „vëllezër“ apo „motra“ .
Përsëhendetja juaj është „Respekti“ dhe „Paqja mes njerëzve“.
Mënyra e përsëhendetje suaj është ulja e kokës në shenjë përsëhendetje.

Kultura e Kaltërt

Vlerat, bindjet dhe qëndrimet

Ju besoni, se ngjarjet kryesore në jetë ndodhin për shkak të fatit dhe kismetit .
Për ju nuk ekziston dyshimi: rezonimi mundet ndonjëherë edhe të të mashtrojë,
por ndjenjat jo.
Vendimi përfundimtarë është më kualitativ, kur e sjell personi me autoritet të lartë.

Karakteristikat joverbale të stilit tuaj të komunikimit

Jeni fleksibil në trajtimin e kohës, sepse për ju nuk ekziston koha e „humbur“.
Kur bisedoni, bashkëbiseduesin e shikoni drejt në sy dhe afroheni afër njerëzve.
Deri sa bisedoni shpesh e prekni apo e kapni bashkëbiseduesin për dore,
krahërori.

Karakteristikat verbale të stilit komunikues

Shpesh e shprehni falënderimin dhe haptazi i tregoni emocionet.
Është normale t'i ndërhyti dikujt në fjalë dhe nuk hidhëroheni kur ata u ndërprejnë
juve.

Normat dhe taridat e sjelljeve në punë

Gruaja është më e mençur se burri, dhe në përputhje me këtë sillen.
U shmangeni konflikteve, kundërshtimeve të drejtpërdrejta dhe grindjeve të
panevojshme.

Përshëndetjet dhe stili i të paraqiturit

Gjatë përshëndetjes, ju e përqafoi bashkëbiseduesin përzemërsisht.
Mënyra më tipike e të përshëndeturit është „ Qofsh shëndosh“.
Të tjerët i i thirrni vetëm me emër dhe gjatë kontaktit me ta shpesh përsëritni
emrin e personit.

Kultura e Kuqe

Vlerat, bindjet dhe qëndrimet

Besoni, se secili njeri është mbret i fatit dhe kismetit të vet.
Një argument i mirë, ka peshë më të madhe, se cilado ndjenjë autentike.
Për ju është me rëndësi, që të gjitha vendimet të sillen në frymë demokratike.

Karakteristikat joverbale të stilit tuaj të komunikimit

Për ju koha është me rëndësi të madhe dhe nuk doni, që ta shfrytëzoni apo
humbni pa nevojë.
Haptazi shprehni emocionet e hidhërimit, pakënaqësisë, gëzimit etj.
Gjatë bisedës ndjeheni më mirë kur jeni larg bashkëbiseduesit (2m).

Karakteristikat verbale të stilit komunikues

Idetë dhe mendimet tuaja i paraqitni pa u hamendur dhe sjellur rrotull.
Shtroni shumë pyetje: një pyetje e mirë vlen më shumë se çdo dije.
Nuk e keni shprehi të falënderoni, sepse tek e fundit secili bën ate që i pëlqen.

Normat dhe taridat e sjelljeve në punë

Sipas mendimit tuaj, konfliktet janë të dobishme dhe të mirëseardhur, sepse
mundësojnë të arrihet deri te vendimi dhe zgjidhja më kualitative.
Mmeshkujt dhe femrat i trajtoni në mënyrë të barabartë.

Përshëndetjet dhe stili i të paraqiturit

Përshëndetja juaj tipike, është shtrëngimi i fortë i dorës.
Të tjerët i përshëndetni me „Mirëdita“.
Të tjerëve u drejtoheni me mbiemër dhe patjetër cekni edhe titullin (profesor/eshë,
doktor/eshë, kolegë/e, student/e etj).

3.2b Tejkalimi i paragjykimeve / „Tri ngjyrat e kulturës“

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturorë – Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Kushtetuta dhe e drejta qytetare, Sociologji, Edukata qytetare, Ora e kujdestarisë
Materiali	- (Teksti mbi mënyrat e tejkalimit të paragjykimeve)
Qëllimi	Që nxënësit/et të provojnë mënyrat e tejkalimit të stereotipeve dhe paragjykimeve, si bariera kyçe në komunikimin interkulturorë.

Hapat

Vërejtje: Kjo punëtori është vazhdim i punëtorisë paraprake (të shihet punëtorja 3.2a).

1. Situata e përshëndetjes (15')

Nxënësit/et, të ndarë në tri grupe (ndarja e njejtë si në punëtorinë 3.2a), vihen në situatën e përshëndetjes dhe paramendojnë paraqitje adekuate, duke e aktruar para të gjithëve.

Zgjedhja e aktrimit për Situatën 1: Mënyrat e ndryshme të përshëndetjes (përqaqimi, shtrëngimi i dorës dhe ulja e kokës në shenjë përshëndetje)

2. Situata e paditjes – Luajtja e roleve (20')

Udhëheqësja/i në mënyrë të shkurtër paraqet Situatën e akuzimit të ndërsjellë (skenari bëhet në bazë të paragjykimeve të paraqitura në punëtorinë paraprake 3.2a).

Aktrimi i Situatës 2 (15') – Nxënësit/et zgjedhin përfaqësuesit/et e tyre, të cilët kanë për detyrë të zgjidhin mosmarrëveshjen. Për aktrim shfrytëzohet teknika e akvariumit (përfaqësuesit ulen në rrethin e brendshëm, kurse anëtarët/et e grupeve të tyre ulen prapa tyre në rrethin e jashtëm si publik, i cili ka të drejtë të sinjalizojë dhe me zë të ulët të suflojë pa e penguar rrjedhën kryesore të punës). Publiku merr një instruksion shtesë, që me anë të ngritjes së dorës (pa fjalë) të paralajmërojë sjelljen dhe thëniet e cilitdo nga anëtarët, të cilët mund të rrezikojnë bisedën dhe eventualisht nxisin ndonjë konflikt.

Udhëheqësi/ja përdorë „prerjen“ për të ngrirë situatën dhe nxit aktorët, që të zbatojnë taktika konstruktive (shembull: në vend të sulmit – tregojnë si ndikon në ta deklarata e dhënë apo çka është me rëndësi për ta që të kuptojnë të tjerët. Në vend të arsytimit- tentojnë të definojnë problemin, gjegjësisht të gjejnë burimin e moskuptimeve. Në vend të kushtëzimit/nënçmimit – të përdorin feedback pozitiv, gjegjësisht njëkohësisht tregojnë në atë çka u pëlqen tek deklarata e palës tjetër dhe tek tipi i ndryshimit të sjelljes, e cila do t'u përshtatej më mirë etj)

3. Reflektimi dhe diskutimi gruporë lidhur me mënyrat e tejkalimit të paragjykimeve (10')

Udhëheqësi/ja nxit nxënësit/et të emërojnë strategjitë dhe taktikat e tejkalimit të paragjykimeve, të cilat i kanë vërejtur në ushtrim dhe t'i lidhin me shkathtësitë dhe teknikat e komunikimit të padhunshëm dhe zgjidhjes së konflikteve.

Në fund udhëheqësi/ja ndan **Tekstin** mbi tejkalimin e paragjykimeve duke dhënë sqarime të shkurtëra..

IDE PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et në mënyrë individuale shkruajnë punimin me temë " Si jam liruar nga paragjykimet", ku përshkruajnë përjetime personale të takimit me pjesëtarin/en e ndonjë grupi apo kulture.

- Nxënësit në mënyrë të organizuar apo individualisht kërkojnë, në çfarë mënyre kulturat tjera e kanë pasuruar jetën e tyre tani në Serbi. Lëmi për të menduar mund të jenë muzika, verimet jashtë vendit, veshëmbathja, gjuhët, librat, filmat, idetë etj.

Teksti

STRATEGJITË PËR ZVOGËLIMIN E PARAGJYKIMEVE

1. Takimet e nivelit interpersonal

a) Takimi individual në mes të dy pjesëtarëve/eve të grupeve apo kulturave të ndryshme, shpesh të lë përshtypje, që ata persona konkret nuk janë përfaqësues tipik të grupit apo kulturës, të cilës i përkasin. Në të vërtetë, ne zakonisht nuk e ndryshojmë mendimin që kemi për atë grup apo kulturë, mirëpo këto përvoja individuale na mësojnë, që në të ardhmen përfaqësuesit e grupeve dhe kulturave tjera, parimisht t'i shikojmë si individë, kurse përkatësia e tyre etnike për ne bëhet më pak e rëndësishme, se sa më parë.

b) Takimet e shpeshta individuale me disa pjesëtarë/e të grupit apo kulturës tjetër, të cilët gjithashtu nuk janë përfaqësues tipik të saj, na mësojnë, që të gjithë përfaqësuesit/et e grupeve dhe kulturave tjera nuk janë të njëjtë dhe se menimi i mëparshëm të cilin e kemi pasur për atë grup apo kulturë, assesi nuk mund të vlejë për të gjithë përfaqësuesit/et e saj.

2. Takimet e nivelit intergruporë

Takimet në mes të grupeve me kultura të ndryshme – të cilët kanë interesime të ngjashme (shembull. Grupe të rinjsh në pushim vjetorë) apo ndajnë detyrat e njëjta (psh. Shkollimi gruporë jashtë vendit) – shpesh si rezultat kanë disa aktivitete të përbashkëta, në të cilat secilit grup i jepet rasti të tregojë ndonjë kualitet që nuk e ka grupi tjetër (psh. Spontaniteti dhe transparenca ndaj organizimit dhe efikasitetit). Në këto situata, zakonisht jemi të impresionuar me kualitetet e treguara të grupeve tjera dhe nuk e kemi problem t'ua pranojmë këtë (pa u frikësuar se do të akuzohemi “për mbajtjen e anës” apo se i “jemi shitur të tjerëve”).

Përvojat e tilla me kalimin e kohës na mësojnë, që pa marrë parasysh mendimet negative që i kemi për të tjerët, secili grup apo kulture ka kualitete që ia vlen t'u kushtohet kujdes.

3. Zbulimi i identitetit të përbashkët grupor

Kur në kuadër të ndonjë organizate (shkolle, firme etj) me qëllime të caktuara formohet një ekip i përbërë prej pjesëtarëve/eve që u përkasin grupeve/kulturave të ndryshme (psh. ekipet sportive apo ekipet artistike, të cilët do t'i prezantojnë në ndonjë garë) zakonisht ndodh, që përfaqësuesi/ja e njëres culture, befaz e përjeton përfaqësuesin/en e grupit tjetër si pjesëtarë/e të “të njëjtit grup”, gjegjësisht edhe përskaaj identiteteve ekzistuese të ndryshme kanë edhe një identitet të përbashkët.

Këto përvoja na mësojnë, që pamarrë parasysh sa dallojmë nga të tjerët, përherë ekziston apo mund të krijohet një bashkësi më e gjerë, të cilës i përkasim të gjithë.

3.3 Seksi dhe gjinia / „Misioni planeti Tokë“

<i>Burimi</i>	<i>Barazia gjinore – doracak për trajnimin e arsimtarëve (CARE)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Kushtetutë dhe e drejta qytetare; Edukata qytetare; Gjuhë serbe; Ora e bashkësisë së klasës;
Materiali	3 ekzemplarë të gazetave të ndryshme ditore(apo javore), letër A4, flomasterë
Qëllimi	Të njohtohen pjesëmarrësit/et me konceptin e gjinisë (përmes vendosjes së dallimeve në mes të seksit dhe gjinisë) dhe me mënyrat në të cilat shoqëria jonë e sheh rolin e gruas dhe burrit.

Hapat

1. Ushtrimi „Misioni planeti Tokë“ (35')

Nxënësit/et ndahen në tri apo katër grupe dhe udhëheqësi/ja i shpie në një situatë fiktive:

Ju jeni nga planeti Ksaoks dhe jeni dërguar në një mision të rëndësishëm në Tokë. Paraprirësja juaj ka konstatuar, se në Tokë jetojnë qenie intelegjente të cilat veten e thërrasin „njerëz“, që ata dallojnë në mes vete, së pari nga ngjyra e lëkurës, gjuha, zhvillimi teknologjik dhe mënyra e të jetuarit. Përveç kësaj, ata kanë parë se njerëzit dallohen edhe sipas seksit, por nuk kanë mundur të thonë asgjë më tepër. Për këtë arsye në mision të ri jeni dërguar ju me detyrë, të përshkruani këto sekse dhe të sqaroni dallimet.

Kur keni arritur në Tokë ka ndodhur një thumbim i madh. Njerëzit filimisht janë frikësuar shumë dhe kanë ikur. Pastaj janë dukur disa të mbuluar me ngjyrë hiri dhe kanë filuar të ju kërcenohen me shkatërrim. Krejt çka keni nga misioni juaj janë këto gazeta, të cilat në momentin e fundit para se të ikni, i keni marrë nga një kanaçe. Programin e përkthimit e keni, por nuk keni kohë, sepse u kanë mbetur vetëm edhe 20 minuta deri te lajmërimi i parë në Kseoks. Filloni menjëherë t'i studioni ato gazeta dhe shkruani një raport të shkurtër për njerëzit dhe sekset e tyre. Mos harroni, gazetatat që i keni, janë burim i vetëm i informimit tuaj.

Secili grup, së pari përgatitë raport me shkrim, të cilin do t'ia dërgojë Kseoksit, e më pas aktron raportimin (lexon raportin) lidhur me atë çka ka mësuar për njerëzit dhe sekset e tyre (çfarë janë ata, cili është roli i tyre, ku i vëreni dallimet etj.)

2. Reflektimi në ushtrim (15')

Udhëheqësi/ja nxit nxënësit/et , të emërojnë gjërat e përbashkëta në këtë raport, gjegjësisht të vërejnë fenomenet kryesore (shembull. Të shkruarit në gjininë mashkullore, disproporcionin e madh në përfaqësimin e meshkujve dhe femrave, tentimet e ndryshme në mënyrën e paraqitjes së tyre në fotografi etj) dhe t'i lidhin ato me rolet reale shoqërore të meshkujve dhe femrave (si në Serbi , poashtu edhe në botë).

Udhëheqësi/ja definojnë seksin dhe gjininë

“Seksi” ka të bëjë me **dallimet biologjike** në mes grave dhe burrave. Ato kryesisht **afatgjate dhe univerzale**.

“Gjinia” ka të bëjë me rolet e **konstruktura shoqërore** të femrave dhe meshkujve. Si e sheh shoqëria rolin e femrave dhe meshkujve dhe çka pret nga secili prej tyre (pritjet shoqërore lidhur me rolet gjinore) varet nga një sërë faktorësh: kulturore, politike, ekonomike, shoqërore dhe religjioze. Në to njësoj ndikojnë edhe traditat, e drejta, përkatësia klasore dhe etnike, si dhe paragjykimet e përhapura në shoqërinë e dhënë. **Qëndrimet dhe sjelljet ndaj gjinisë janë të mësura dhe mund të ndryshohen.**

Në fund nxënësve/eve u dnahet dhe shkurt komentohet Teksti mbi dallimet në sjelljet e femrave dhe meshkujve.

Teksti

♀ Dallimet në të folurit dhe sjelljet e grave dhe burrave ♂

Dallimet, që do t'i gjeni këtu janë rezultat i shumë studimeve të bëra. Mos harroni, se të gjitha këto dallime janë të kushtëzuara dhe të mësuara në mënyrë shoqërore.

♣ PËRDORIMI I GJUHËS

♀ FEMRAT	♂ MESHKUJT
flasin qetë	flasin me zë të lartë
theksojnë intonacionin dhe akcentimin	theksojnë fuqinë e zërit
shfrytëzojnë përafërsisht 5 tone në të folur të folurit është më emotiv	shfrytëzojnë përafërsisht 3 tone në të folur të folurit është monoton
më pak i ndërpresin të tjerët dhe lejojnë më shumë ndërprerje	i ndërpresin të tjerët, kurse më pak lejojnë të ndërpriten
paraqesin më shumë të dhëna personale	paraqesin më pak të dhëna personale
nuk paraqesin akuza të drejtpërdrejta, së pari pyesin: "Përse nuk thërret?"	paraqesin akuza të drejtpërdrejta: "Nuk po thërret."
Japin më pak deklarata të drejtpërdrejta dhe sillen vërdallë, nuk përdorin fjalitë deklaruese, por shpesh nga ato deklaruese me anë të intonacionit formulojnë pyetjet: "Është një ditë e bukur, apo jo?"	Japin deklarata të drejtpërdrejta dhe rrallë sillen vërdallë, përdorin fjalitë deklaruese: "Sot është një ditë e bukur."
Shfrytëzojnë më tepër intensifikues "shumë", "aq", "fort", "me të vërtetë" ...	Përdorin më pak intensifikues, për t'i dhënë deklaratave të tyre rëndësi më të madhe
Gjatë ndryshimit të temës përdorin lidhëzat "dhe", "por", "ndoshta"...	Gjatë ndryshimit të temës përdorin fjalët "hej", "oh", "dëgjo"...
Shtrojnë më shumë pyetje për të mbajtur bisedën	Shtrojnë më pak pyetje për të mbajtur bisedën
Mundohen, që me biseda rreth jetës personale të arrijnë marrëdhënie më të mira në punë	Rrallë flasin për jetën personale lidhur me punën

♣ ♣ KARAKTERISTIKAT PSIKOLOGJIKE

Problemeve u qasen, duke i lidhur me përvojat e ngjashme të hidhura	Në mënyrë praktike u qasen zgjidhjes së problemeve
Qasja në probleme është më emotive	Qasja në probleme është analitike
Më parë do të kërkojnë dhe pranojnë ndihmë	Më pak është e besueshme, se do të drejtohen për të kërkuar ndihmë apo për ta pranuar atë.
Shpesh shprehin kujdes për të tjerët: "A janë të gjithë mirë?"	Shpesh kujdesen për organizimin e punës: "Çka do të punojë secili?"
Janë më intuitivë dhe më shumë i kushtojnë kujdes detajeve	Janë më pak intuitivë dhe nuk u kushtojnë kujdes detajeve
Kanë më pak vështirësi për t'i shprehur ndjenjat intime	Më vështirë i shprehin ndjenjat intime
Janë të më të gatshme, që perms vajit të lirohen nga hidhërimi	Janë të gatshëm të bërtasin, shajnë apo përdorin forcën për t'u liruar nga hidhërimi
Më tepër flasin për ndjenjat e tyre dhe marrëdhëniet me të tjerët	Më tepër flasin për atë çfarë kanë bërë, ku kanë qenë, e më pak për marrëdhëniet e tyre me të tjerët.

♣ ♣ ♣ ♣ ♣ POZITA E TRUPIT

Zëjnë më pak hapësirë fizike, rrijnë me duar dhe këmbë për trupi	Zëjnë më shumë hapësirë fizike, rrijnë me dur dhe këmbë të shtrira
Gjestikulojnë kah trupi	Gjestikulojnë nga trupi
Përkulen më shumë përpara kur rrijnë, e posaçërisht kur dëgjojnë bashkëbiseduesin	Tërhiqen prapa kur ulen dhe kur dëgjojnë bashkëbiseduesin.
U kushtojnë rëndësi sinjaleve joverbale të të tjerëve	Nuk u kushtojnë kujdes sinjaleve joverbale të të tjerëve
Mbajnë distancë më të madhe ndaj meshkujve dhe bhapsirës së tyre personale	U ofrohen femrave shumë afër hapsirës së tyre personale

3.4 Konstruksioni social i roleve gjinore

<i>Burimi</i>	<i>Gratë munden ta bëjnë këtë, doracak për trajnim (NPA)</i>
Kohëzgjatja	25 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Kushtetutë dhe e drejta qytetare; Edukatë qytetare; Gjuhë serbe; Ora e bashkësisë së klasës;
Materiali	-
Qëllimi	Të dallohet, se si kalimi nga njëra në sferën tjetër të jetës shoqërore nuk është e njëjtë për femrat dhe meshkujt dhe se numri/ndikimi i femrave zvogëlohet me rritjen e fuqisë vendosëse.

Hapat

1. Prezantimi (10')

Udhëheqësi/ja përmbledh rrëfimin mbi gjininë dhe seksin, përmes segmenteve të ndryshme shoqërore (familja, arsimimi dhe profesioni, angazhimi shoqërorë dhe vendi i sjelljes së vendimeve), të cilët janë paraqitur si rathë koncentrikë të ndikimit dhe fuqisë shoqërore dhe konstaton se numri/ndikimi i femrave zvogëlohet me rritjen e fuqisë vendosëse.

Udhëheqësi/ja u ndan nxënësve/eve **Tekstin- a e keni ditur se?** dhe e lexon me zë (apo e paraqet në pano).

2. Diskutimi i nxënësve/eve (15')

Udhëheqësi/ja inicon diskutim gruporë me pyetjet: Çka mendoni ju për faktin, se sot në botë gratë përbëjnë 51% të popullatës botërore, kurse kryejnë vetëm 2% të funksioneve ekzekutive në pushtet? Apo: Nëse gratë marrin 10% nga të ardhurat e përgjithëshme botërore, si është e mundur atëherë të posedojnë vetëm 1% të pasurisë së përgjithëshme?

Udhëheqësi/ja u përkujton(e sipas nevojës e dhe sqaron) se **rolet** e femrave dhe meshkujve janë të konstruara në mënyrë shoqërore dhe se raporti ndaj grave/burrave dallon nga kultura në kulturë dhe ndryshon (rekonstruohet, dekonstruohet etj) nëpër epoka. Udhëheqësi/ja më pas tregopn Tekstin tjetër mbi konstruktimin e roleve gjinore dhe ua ndan nxënësve/eve.

Në fund, disa pyetje mund të mbeten të shkruara në një pano të veçantë me emrin „Pyetje për të menduar“ (apo ngjashëm) dhe tek këto pyetje mund të ktheheni në kuadër të ndonjë njësie tjetër mësimore, e cila merret me temën e pyetjeve të parashtruara.

IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit në mënyrë të organizuar gjurmojnë dhe përgatitin prezantimin lidhur me pozitën e gruas në Serbi.
- Nxënësit/et në mënyrë individuale apo të organizuar gjurmojnë dhe shkruajnë ese për gratë, të cilat kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e shkencës, artit dhe shoqërisë në përgjithësi (zgjedhin lëndën).
- Nxënësit/et në mënyrë të organizuar vizitojnë studiot e grave apo ndonjë organizatë joqeveritare grashë në qytetin e tyre (apo kërkojnë në internet) dhe shkruajnë një artikull gazetaresk për këtë vizitë.
- Nxënësit/et në ekip gjurmojnë temën e dhunës në familje dhe masat që ndërmirren për eliminimin e kësaj dukurie (psh. Shtëpitë e sigurta, sos-telefonët për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës etj), te ne dhe në botë.

A E KENI DITUR SE?
(SHËNIME NGA BOTA/ 2002.)

1. Gratë përbëjnë 51 % të popullatës botërore, kurse kryejnë 2% të funksioneve ekzekutive në pushtet.
2. Vetëm 14% e ushëheqësve janë gra.
3. Nga puna e përgjithëshme grave, 66% e punës së tyre është pa pagesë (33% e meshkujve).
4. Gratë marrin vetëm 10 % të ardhura nga të ardhurat e përgjithëshme botërore.
5. Numrin prej 1.3 miliardë njerëz të varfër në botë, e përbëjnë femrat me 70 %.
6. Gratë posedojnë vetëm 1% të pasurisë së përgjithëshme.

KONSTRUKSIONI SOCIAL I ROLEVE GJINORE

Dallimet në konceptimin e roleve të meshkujve dhe femrave, mund të vërehen në kontekste të ndryshme:

Shoqërore Shpresat e ndryshme nga rolet shoqërore të femrave dhe meshkujve: mashkulli si kryesues i familjes dhe ai që fiton, gruaja si ajo që lind, ushqen dhe kujdeset (për fëmijët të moshuarit).

Politike Dallimet në mënyrat, me të cilat gratë dhe burrat arrijnë dhe ndajnë autoritetin: meshkujt janë më azhur në politikën nacionale dhe ate të lartë, kurse gratë në nivelin lokal dhe politikën lokale, që ka të bëjë me rolet e tyre në amvisëri.

Arsimore Dallimet në mundësinë e të arriturit arsimorë dhe pritjet e ndryshme nga vajzat dhe djemtë: familja i jep kahje më parë arsimimit të djemve se sa të vajzave, vajzat kryesisht shkojnë në drejtime më pak prestigjioze

Ekonomike Dallimet në dhënien e mundësisë së përparimit në karrierë, kontrollimin e finansave dhe vlerave tjera prodhuese, kreditë, huatë, pronësia në tokë.

3.5 Diskriminimi / „Shumica dhe pakica“

Burimi Marrë nga programi „Becavta“ (Sëbashku), Instituti, Adam Izrael
Kohëzgjatja 90 minuta (2 x 45 min.)
Lënda(ët) Edukatë qytetare; Psikologji; Kushtetuta dhe e drejta qytetare; Sociologji
Materiali

Qëllimi Të njohohen pjesëmarrësit/et me fenomenin e diskriminimit dhe mekanizmeve veprues përmes përjetimeve të personave të diskriminuar dhe ndarjen e ndjenjave me ta.
Të shijohet, që njeriu, edhe kur i përket shumicës, mund të ndodhet në pozitën e pakicës.

Hapat

1. Tre vullnetarë (20')

Udhëheqësi/ja u sqaron nxënësve/eve, se ushtrimi në vijim në të vërtetë është një lloj loje dhe se ekzistojnë shumë mënyra, se si mund të luhet kjo lojë, gjegjësisht që nuk ka sjellje „të drejtë“ apo „të gabuar“.

Udhëheqësi/ja kërkon tre vullnetarë. Vullnetarët duhet menjëherë t'a lëshojnë hapsirën ku luhet loja, sepse nuk guxojnë të dëgjojnë për çka bëhet fjalë.

Me rëndësi: Duhet pasur kujdes, që këta të jenë vullnetarë të vërtetë dhe nuk bën asnjërit prej tyre t'u imponohet ky rol. Prapëseprapë, duhet pasur kujdes që këta të mos jenë individë, që në grup kanë pozitën e të „margjinalizuarve“, sepse për ta ky ushtrim do të ishte tejet i rëndë.

Pasi që vullnetarët, të kenë lëshuar hapsirën, pjesëmarrësit/et tjerë marrin materialin, nga i cili mund të punojnë ndonjë simbol, i cili do t'i definonte si grupë. Udhëheqësit lusin anëtarët e grupit të mirren vesh edhe për disa shenja tjera të përbashkëta për ta:

- a) të merren vesh për gjestet, fjalet e koduara dhe për tabutë eventuale.
- c) të gjejnë ndonjë temë kontraverse me interes të përgjithshëm, për të cilën do të diskutojnë
- g) është e mundur të merren vesh edhe për ndonjë simbol të dukshëm, të cilin do ta mbanin të gjithë, por kjo nuk është e domosdoshme. (Nëse nuk ka kohë për përgatitje, mund të merren vesh, që të gjithë të zbathin këpucët apo ngjashëm)

Shembuj:

Simbolet - Pika me ngjyrë e ngjitur në ballë.
Tabutë - Koha dhe krejt çka ka të bëjë me të, është e ndaluar. Askush nuk mban orë.

Në çdo pyetje për kohën, të gjithë fillojnë të fishkëllojnë..

Kodet joverbale- Çdo herë kur dikush thotë Ne, të gjithë ngriten....
Kodet verbale - Lidhur me temën pirja e duhanit, termi i pirjes së duhanit zëvendësohet me termin lexim kurse termi cigare zëvendësohet me termin libër.
Tema edukim: mësuesit- kopështarët, fëmijët-lulet.

Me rëndësi: Nuk duhet marrë më shumë se 4 elemente të tilla, sepse komplikohet.

Grupit i jepet kohë e shkurtër, për të provuar diskutimin, e më pas hyjnë vullnetarët- së pari njëri, e pas pesë minutash edhe dy të tjerët. Është e mundur të lihen brenda që të tre së bashku, nëse udhëheqësi/ja mendon sekjo gjë do të ishte shumë e pakëndëshme për një person.
Nxënësit/et në grupë, sigurisht do të nisen prej supozimit të heshtur, se kodet për të cilat janë marrë vesh nuk duhet treguar vullnetarëve, sepse ata duhet t'i zbulojnë vetë.

Udhëheqësi lut vullnetarët të futen brenda dhe të provojnë të kyçen në grup.

Varianti alternativ për ushtrimin - Është e mundur të lihen vullnetarët të hyjnë brenda pa kurrëfarë udhëzimesh, çka do të duhej të bënin, gjegjësisht ata lirshëm vendosin si do të sillen kur të hyjnë.

2. Reflektimi (25')

Udhëheqësi/ja i ka parasysh tre skenare të mundëshme të këtij ushtrimi:

- Vullnetarët nuk e kuptojnë çka diskutohet në grupë dhe nuk tentojnë të kyçen në diskutim apo të ulen në rreth. Mbeten të izoluar apo tentojnë të komunikojnë në mes veti.
- Vullnetarët tentojnë në mënyrë individuale apo së bashku të vejnë kontakt me anëtarët e grupit. Grupi i injoron apo u'a pamundëson tentimin e tyre të integritimit.
- Vullnetarët i'a dalin të integrohen dhe grupi i pranon. Ulen në rreth dhe fillojnë të marrin pjesë në diskutim.

Evaluimi i lojës: Loja shkakton kënaqësi të madhe për shumicën e pjesëmarrësve, që gjenden në pozitën e shumicës. Për vullnetarët, nuk është edhe aq argëtuese, sepse shpesh shkakton hidhërim. Gjatë fazës së reflektimit duhet paralajmëruar, se sjellja e shumicës, ka qenë e kushtëzuar me rregullat e lojës dhe supozimet e saj heshtëse, mirëpo ndjenjat e përjetuara, refuzimet dhe frustracionet, gjegjësisht fuqisë në mbi fuqi kanë qenë ndjenja të vërteta, të rëndësishme për kuptimin e qëllimit të kësaj loje.

Te vullnetarët, sigurisht tensioni ka qenë më i madhi. Për këtë arsye, duhet që ata të parët të paraqesin atë çka kanë përjetuar.

Në këtë lojë, është me rëndësi, që nxënësit të kuptojnë, sa e lehtë është të ndodhë, që njeriu si pjesëtarë i shumicës ta diskriminojë pakicën, bile edhe kur këtë gjë nuk e ka bërë me vetëdije. Është e nevojshme të diskutohet edhe rreth procesit, i cili ndodh brenda grupit shumicë. Ndoshta disa individë kanë dëshiruar të sillen ndaj pakicës në mënyrë tjetër, por nuk e kanë bërë këtë për shkak të presionit që kanë pasë prej grupit. Përveç kësaj, nxënësit/et mund të shohin sa të mëdha janë dallimet gjatë vlerësimit të sjelljes së dikujt. Shumica buzëqeshjen e vet, për ndonjë arsye do ta përjetojë si diçka të çuditshme dhe do të jetë i habitur, me faktin se kjo e qeshur te pakica ka shkakuar ndjenjë rrezikimi dhe fyerje.

Ushtrimi nuk guxon të shpie deri te situata, në të cilën nxënësit/et, për shkak të sjelljes së tyre ndihen „fajtorë“ para pakicës. Nëse ka nevojë udhëheqësi /ja, mund të përmendë, se kjo situatë është krijuar në menyrë të vetëdijshme dhe për këtë arsye nuk ka mundësi, që në bazë të sjelljes në këtë lojë të nxirren konkluzione lidhur me karakterin e dikujt etj.

Në hapin e fundit, është e nevojshme që përvojat nga kjo lojë të barten në situata reale nga jeta e nxënësve/eve dhe raporte reale shoqërore.

Shembull - Mund të bisedohet mbi kodet e veçanta:

shenjat e jashtme - pika në ballë - përkatësia kasti;

tabu temat - nuk flitet për paratë


kodet joverbale – ritualet e përshëndetjes nëpër shoqëri të ndryshme, psh puthja dhe përshëndetja për dore etj

kodet verbale: slengu, dialekti etj.

Varianti alternativ: Udhëheqësi/ja mundet, që nxënësve/eve t'ua ofrojë „skemën e diskriminimit“ (të shihet materiali punues i paraqitur në fund) dhe t'i lusë ata, që ndonjë shembull të zgjedhur (ndonjë raport real s shoqërorë apo ndonjë shembull të njohur në histori) t'a analizojnë duke shfrytëzuar modelin në fjalë.

IDE PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et në ekip gjurmojnë dhe përgatitin prezantimin e teksteve nga gazetatat, në të cilat flitet për ndonjë grupë pakicë.



3.6 Takimi i grupit të shumicës me ate të pakicës – përvojat pozitive

Burimi	<i>Twinning Tehnikarijum – Përmbledhje e veprimeve inovative dhe teknikave për përparimin e punës së shkollave dhe drejtorive të shkollave të Ministrisë së arsimit (Twinning projekti, MPS)</i>
Kohëzgjatja	90 minuta
Lënda(ët)	Kushtetuta dhe e drejta qytetare; Edukatë qytetare; Psikologji; Sociologji
Materiali	FC letër, markerë, letër A4 , lapsa
Qëllimi	T'u tregohet nxënësve/eve, se si shembujt e përvojave pozitive mund t'i kontribuojnë mirëkuptimit dhe përparimit të raporteve ndërmjet pjesëtarëve të grupeve shumicë dhe pakicë.

Hapat

1. Hyrje (5')

Udhëheqësit/et u shpjegojnë nxënësve, se në këtë ushtrim do të merren me gjurmimin e përvojave pozitive, deri te të cilat është ardhur me rastin e takimit në mes të përfaqësuesve të grupeve shumicë dhe pakicë. Ky lloj gjurmimi quhet „ gjurmim me respekt“ (*appreciative inquiry*), kurse metoda kryesore, e cila shfrytëzohet është intervista.intervistimi do të realizohet në çifte, me ç'rast njëri anëtar i çiftit do të jetë përfaqësues i grupit pakicë, kurse naëtari tjetër përfaqësues i grupit shumicë.

2. Intervista në çifte (15')

Kur nxënësit të kenë formuar çiftet, udhëheqësja u'a ndan pyetësorët dhe u jep udhëzime për udhëheqjen e intervistës. Secili anëtarë i çiftit i ka 5 minuta për parashkrimin e pyetjeve.

3. Ndërrimi gruporë (40')

Nga çiftet të formohen grupe të vogla (nga 3-4 çifte punojnë së bashku varësisht nga madhësia e grupit). Së pari, secili anëtarë i grupit me disa fjali përsëritë përgjigjet e personit të intervistuar. Pas kësaj grupi bën tri pano – Shembujt të përvojës pozitive, Nevojat e grupit shumicë dhe pakicë dhe Propozime për përmirësimin e raporteve, me ndihmën e të cilëve përmbledhet ajo që është thënë.

4. Të mësuarit në bazë të përvojave pozitive (30')

Përfaqësuesit e grupeve tregojnë panot, e pas kësaj diskutohet lidhur me atë, se çka është e përbashkët për të gjitha shembujt e përvojës pozitive (2) në ç'masë nevojat e grupit shumicë dhe pakicë janë të njejta, të ndryshme, kundërshtuese apo komplementare dhe (3) çka mund të ndërmirret, që mirëkuptimi në mes të grupit shumicë dhe pakicë të përmirësohet dhe të përparojnë raportet.

IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit/et në ekip dhe me ndihmën e mentorit paramendojnë një intervistë dhe e realizojnë me personat të cilët konsiderohen „kronik lokal“, e më pas shkruajnë një artikull të shkurtër gazetaresk për ndonjë ngjarje nga e kaluara e bashkësisë lokale, ngjarje kjo që i ka kontribuar mirëkuptimit ndërmjet grupit shumicë dhe pakicë dhe ka shënuar përparim në raportet në bashkësinë lokale (orët e historisë, sociologjisë etj).

KËSHILLA PËR UDHËHEQJEN E INTERVISTËS

- Bëhuni të kujdesëshëm dhe tregoni empati
Lereni bashkëbiseduesin të tregojë rrëfimin e tij. Mos i paraqitni përvojat tuaja. Mos e paraqitni mendimin tuaj për atë çka dëgjoni.
- Bëhuni kureshtarë
Përherë mund të shtoni pyetje plotësuese: Çka ndodhi më tej? Çka ishte me rëndësi për ty? Si ndryshoi kjo me kalimin e kohës? Si e shihni këtë nga këndvështrimi i sotëm? etj...
- Mos nxitoni!
Nuk është lehtë të përgjigjeni në pyetjet e formuluar në mënyrë mjaft të hapur.
Jepni kohë për pauza dhe për të menduar.
- Silluni me respekt!
Nëse partneri juaj nuk dëshiron të përgjigjet në ndonjë pyetje, kjo është në rregull.....
- Merrni shenime të shkurtëra!
Shkruani deklaratat kyçe, për të përkujtuar më vonë çka ka thënë partneri Juaj.

PYETJET PËR PËRFAQËSUESIN E GRUPIT PAKICË

- Përshkruani përvojën tuaj më pozitive, të cilën e ke përjetuar gjatë kontaktit me grupin shumicë. Provo të përcaktosh një situatë, kur je ndier shumë qasës dhe për të cilën je ndier se je kënaqur gjatë ndrrimit. Cilat kanë qenë rrethanat atëherë? Çka ke mësuar të re për grupin shumicë gjatë këtij kontakti? Çka ka qenë për ty më e rëndësishme?....
- Çka keni nevojë ju dhe të rinjtë tjerë nga grupet pakicë, që në të ardhmen të përjetoni përvoja të tilla?
- Sipas jush, si mund të përparojnë raportet ndërmjet grupeve pakicë dhe shumicë? Si mund të përmirësohet mirëkuptimi?

PYETJET PËR PËRFAQËSUESIN E GRUPIT SHUMICË

- Përshkruani përvojën tuaj më pozitive, të cilën e ke përjetuar gjatë kontaktit me grupin pakicë. Provo të përcaktosh një situatë, kur je ndier shumë qasës dhe për të cilën je ndier se je kënaqur gjatë ndrrimit. Çka ke mësuar të re për grupin pakicë gjatë këtij kontakti? Çka ka qenë për ty më e rëndësishme?....
- Çka keni nevojë ju dhe të rinjtë tjerë nga grupet pakicë, që në të ardhmen të përjetoni përvoja të tilla?
- Sipas jush, si mund të përparojnë raportet ndërmjet grupeve pakicë dhe shumicë? Si mund të përmirësohet mirëkuptimi?

3.7 Mundësitë e pabarabarta / „Fillo të bësh diçka“

Burimi	<i>It's Only Right! - A Practical Guide to Learning About the Convention on the Rights of the Child (UNICEF)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët):	Kushtetuta dhe e drejta qytetare, Psikologji, Sociologji
Materiali	FC letër, gërshërë, markerë, flomasterë, post-it letra me ngjyra të ndryshme, letër A4
Qëllimi	Të tregohet në rrezikun nga parashikimi i diskriminimit, kur ai është ngritur në sistem, gjegjësisht i institucionalizuar, të sillen reagimet asertive, si model i kundërshtimit të padhunshëm dhe orvatjet për të drejtat personale.

Hapat

Kushtet për mbajtjen e ushtrimit: Në hapsirën punuese, është e nevojshme që para se të fillohet me ushtrimin, të organizohen tri hapsira punuese në mënyrën si në vijim- një tavolinë më të madhe të vendoset në atë mënyrë, që të kesh mundësi t'i ofroresh nga të gjitha anët (kjo tavolinë duhet të merr ½ e hapsirës), kurse dy tavolina më të vogla të vendosen afër murit.

1. Hyrje (5') – Udhëheqësi/ja u'a përkujton nxënësve, se arsimimi interkulturore- është arsimim i cili respekton dhe përkrahë dallimet në të gjitha lëmitë e jetës së njeriut. Njëkohësisht, bëhet fjalë për arsimin, i cili i kundërvihet padrejtësive dhe diskriminimit, dhe i cili është për barazi dhe të drejtat e njeriut. Për këtë arsye, detyra e tyre gjatë ushtrimit „ Fillo të bësh diçka“ do të jetë, që së pari të mendojnë e pastaj të punojnë një pano, me ndihmën e të cilës do të promovojnë arsimin interkulturore në shkollën apo bashkësinë lokale të tyre.

2. Ushtrimi "bëj diçka" punim i panove (30')

Udhëheqësi/ja ndan nxënësit/et në tri grupe (me njërin nga metodat për ndarjen e rastësishme në grupe) duke pasur parasysh, që njëra prej grupeve ka dukshëm më pak anëtarë. Grupin më të vogël, udhëheqësja e vendos në tavolinën më të madhe dhe më qasëse (Ky është „grupi i privilegjuar). Dy grupet tjera i vendosë nëpër tavolinat e vogla, të vendosura afër murit (Këto janë grupet e diskriminuara).

Vërejtje: Nëse nxënësit/et ankohen, duhet thënë që këto janë kushtet në të cilat zhvillohet ky ushtrim.

Udhëheqësi/ja pret pak, deri sa pjesëmarrësit të fillojnë të merren vesh rreth konceptit të panos, e më pas u ndan materialin punues. „Grupet e diskriminuara“ për vizatimin e panos marrin dy FC letra, markerë dhe flomasterë me ngjyra të ndryshme dhe post-it letra me ngjyra të ndryshme.

Vërejtje: Shpërndarjen e materialit duhet bërë pa u „vërejtur“. Mirëpo, nëse nxënësit/et ankohen, në mënyrë të vendosur u bëhet me dije, se këto janë kushtet në të cilat zhvillohet ky aktivitet.

Kur nxënësit të kenë imagjinuar plaketat vijon **prezantimi i punimeve grupe.**

3. Reflektimi (10')

Në grupin e madh, së pari nxënësit/et që kanë qenë në „grupin e diskriminuar“ flasin për përshtypjet e veta gjatë këtij ushtrimi- në cilin moment e kanë vërejtur shpërndarjen e pabarabartë të resurseve, si ka ndikuar tek ata ky lloj diskriminimi dhe çka kanë ndërmarrë lidhur me këtë. Më pas, përvojnë e vet e komunikon edhe „grupi i privilegjuar“. Udhëheqësi/ja përmbledh fenomenet e vërejtura dhe i ndërlidh me skemën e diskriminimit (të shihet materiali punues në punëtorinë paraprake 3.5).

Me nxënësit/et më pas diskutohet lidhur me ate, se cilat të drejta të njeriut kanë qenë të rrezikuara në këtë ushtrim dhe në cilat mënyra, anëtarët e grupeve të diskriminuara kanë mundur të deklarohen për të drejtat e tyre.

IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit/et në ekip gjurmojnë dhe përgatitin prezantimet mbi institucionet dhe organizatat (lokale, në nivel shtetërorë dhe ndërkombëtarë), të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

4 Të drejtat e njeriut dhe sjellja me përgjegjësi

Pjesa dërmuese e kësaj lëmie mbulohet me programin e punëtorive nga Edukata qytetare për vitin e dytë të shkollës së mesme.

4.1 Shikuar nga aspekti medial: Kush flet për të drejtat e njeriut?

<i>Burimi</i>	<i>HR Education Project, CDVEC Curriculum development Unit (Ireland, 1999)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda (ët)	Kushtetutë dhe e drejta qytetare; Edukata qytetare; Psikologji; Sociologji
Materiali	Përmbledhje gazetash të reja, Kopje të fletushkave mediale, kopja e deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut (teksti i komplet dhe kopja e versionit të thjeshtëzuar).
Qëllimi	Të zhvillohet aftësia e nxënësve/eve, për të identifikuar dhe diskutuar çështjet, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, e të cilat janë të dukshme edhe në media.

Hapat

1. Analizimi i teksteve gazetareske

Nxënësit/et ndahen në grupe të vogla, të përbëra prej 4-5 pjesëmarrës për secilin grup. Udhëheqësi/ja i jep secilit grup nga tre ekzemplarë të gazetave ditore, një formular medial dhe kopjet e (integrale dhe versionin e shkurtuar) Deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut (DUDNJ). Udhëheqësi/ja kërkon nga nxënësit/et të eksplorojnë gazetat dhe duke i shfrytëzuar kopjet e DUDNJ, të plotësojnë fletushkën mediale. Kurt ë mbarojnë, secili grup zgjedh prezantuesin, i cili do të prezanton produktet deri tek të cilat ka ardhur grupi, gjegjësisht të përshkruhen shembujt e teksteve, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Iraporti i prezantuesve/eve duhet të përmbajë:

- Çështjen qendrore të të DNJ në tekst
- Cilat nene të DUDNJ sillen lidhur me tekstin
- Cilët individë, grupe apo institucione i kanë identifikuar, se punojnë për promovimin apo mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

2. Diskutimi i grupit:

Udhëheqësi/ja oditel/jka nis diskutimin me pyetjet në vijim:

- Çka keni mësuar gjatë këtij aktiviteti, sa është e përfshirë tema për të DNJ në media?
- Sipas mendimit tuaj, cili është roli, dhe luajnë fare rol, mediat në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut?

IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit/et i shkruajnë letër gazetave, me anë të të cilës përkrahin/kritikojnë/promovojnë aktivitetet nga lëmia e të drejtave të njeriut.
- Nxënësit/et në ekip shkruajnë projekt, të cilin duhet ta realizojnë dhe me këtë të sjellin ndryshimet e dëshiruara në shkollë apo bashkësinë lokale.
- Nxënësit/et në ekip përgatitnin materialin punues për të tjerët (nxënësit më të rinj).
- Nxënësit/et organizojnë garë në ilustrim, prodhim të pllakatave etj.

Materiali punues

LISTA MEDIALE			
detajet gazetarske emri i gazetës dhe data titulli i tekstit			
Fjalët kyçe të cilat mund t'iu ndihmojnë për të mbajtur në mend tekstin			
Cilën çështje nga lëmia e të drejtave të njeriut e keni gjetur në këtë tekst?			
Cilët anëtarë nga UDLP kanë lidhje me tekstin?			
A përmendet në tekst çfarëdo emri /grup/institucion , që punon në promovimin apo mbrojtjen e të drejtave të njeriut?			

Teksti

DEKLARATA UNIVERSALE MBI TË DREJTAT E NJERIUT - versioni i shkurtuar -
<p>neni 1. e drejta në barazi neni 2. e drejta në lirinë nga diskriminimi neni 3. e drejta për të jetuar, liri dhe siguri të personalitetit neni 4. e drejta për liri nga robëria neni 5. e drejta për t'u mbrojtur nga mundimet dhe veprimet nënçmuese neni 6. e drejta, që para ligjit të pranohesh si personalitet neni 7. e drejta në barabarësi para ligjit neni 8. e drejta për këshillë juridike prej gjykatave kompetente neni 9. e drejta për mbrojtje nga burgosja dhe ndjekja me vetëdëshirë neni 10. e drejta për t'u marrë në pyetje dhe për t'u gjykuar në mënyrë të drejtë neni 11. e drejta që i akuzuari, të konsiderohet jofajtor, deri sa të provohet e kundërta. neni 12. e drejta për ruajtjen e privatësisë, familjes dhe shkresave neni 13. e drejta për lirinë e lëvizjes edhe jashtë vendit neni 14. e drejta për vendstrehim në vendet tjera nga ndjekja neni 15. e drejta për shtetësi dhe liri për ta ndrruar atë. neni 16. e drejta për martesë dhe krijimin e familjes neni 17. e drejta për pasuri personale neni 18. e drejta për liri në bindjet dhe përkatësinë fetare neni 19. e drejta për lirinë e të menduarit dhe informimit neni 20. e drejta në liri për t'u tubuar dhe bashkuar qetë neni 21. e drejta të merr pjesë në udhëheqjen e punëve publike të vendit të tij dhe e drejta në zgjedhje të lira neni 22. e drejta për sigurim social neni 23. e drejta për punë, zgjedhje të lirë të punësimit dhe organizim në sindikata neni 24. e drejta për pushim dhe kohë të lirë neni 25. e drejta në standard jetësor të përshtatshëm neni 26. e drejta për arsimim neni 27. e drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore të bashkësisë së vet neni 28. e drejta në rregullim shoqërorë dhe ndërkombëtarë, të vërtetuar me këtë Deklaratë neni 29. Secili ka obligime ndaj bashkësisë së vet, në të cilën është i mundur vetëm zhvillimi i plotë dhe i lirë i personalitetit të vet neni 30. e drejta për të mbrojtur anulimin e këtyre të drejtave dhe lirive të vërtetuara nga ana e ndonjë shteti, grupi apo individi.</p>

4.2 Zgjidhjet tona të stileve jetësore ndikojnë në njerëzit tjerë

<i>Burimi</i>	<i>Changing Perspectives, Cultural values, Diversity and Equality in Ireland and the Wider World, (2002), A Resource for Civic, social and Political Education, Dublin</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Edukatë qytetare; Kushtetutë dhe e drejta qytetare; Ora e bashkësisë së klasës; Afarizmi tregtar; Ekonomia e tregtisë
Materiali	Fotokopjet e materialit punues(Informata mbi patikat dhe fakte mbi punëtorët), lapsa dhe flomasterë, FC dhe markerë
Qëllimi	Të ndihmohen të rinjtë të bëhen të vetëdijshëm, në çfarë mase stili jonë jetësorë harxhues prodhon padrejtësinë për njerëzit, që u përkasin shoqërive më të varfëra se jona. Të nxiten për të shqyrtuar fuqinë e tyre, të cilën e kanë si harxhues në funksion për të mirën e njerëzve tjerë.

Hapat

1. Hyrje

Ky aktivitet ka të bëjë me ndërvarshmërinë dhe raportet fer në tregti. Të rinjtë shpesh janë të interesuar të kenë etiketë/brend „të vërtetë të garderobës apo mbathjeve, pa u menduar fare ku dhe në çfarë kushtesh janë prodhuar këto sende. Një pjesë e madhe e stilit tonë të tashëm jetësor është i bazuar në sistemin e tregtisë botërore, me të cilën favorizohen vendet më të pasura, kurse eksploatohen punëtorët në vendet e varfëra. Vendet e varfëra kryesisht sigurojnë lëndë të para për të pasurit, mirëpo në këtë shkëmbim i ekspozohen kushteve të padrejta të tregtisë. Kjo është një lëmi mjaft e gjerë për eksplorim me nxënësit dhe ekzistojnë materiale të mira për t'u marrë me shumë probleme në këtë sferë. Të para! qesim një shembull të eksploatimit nga ana e kompanive multinacionale në sferën e mbathjeve sportive, e cila ka qenë shkak për t'u merakosur dhe fushatë, disa vite me radhë.

2. Përgatitja

Të fotokopjohet lista punuese: Informatat mbi patikat, ashtu që secili nxënës/e të ketë kopjen e vet, si dhe faktet për punëtorët në Indonezi. Me siguri do të donit të shikonit ndonjë nga web.faqet të cilat do t'i paraqesim në vazhdim të tekstit, në mënyrë që edhe vetë të informoheni për këtë problem para orës.

4. Detyrë për nxënësit/et

Udhëheqësi/ja fton pjesëmarrësit/et të përkujtojnë cilat sende (të cilat i shfrytëzojmë apo hajmë çdo ditë) na lidhin me pjesët tjera të botës.

Më pas i ndan në grupe të vogla dhe i fton të flasin lidhur me çështjet në vijim apo ngjashëm:

- A do ta blenit ndonjë prodhim, sikur të dinit, se fabrika eksploaton njerëzit që kanë prodhuar këto gjëra apo këtë ushqim. Përse?
- A do të blenit ndonjë prodhim, i cili është prodhuar në ndonjë fabrikë që i bën dëm shëndetit të punëtorëve të saj apo njerëzve tjerë? Përse?
- A do të ishit të gatshëm, të paguani çmim më të lartë për diçka si psh. Garderobë, ushqim, me kusht që njerëzit të cilët i kanë bërë këto të fitojnë një pagë të drejtë/ fer. Psh. Sa do të paguanit për një palë patika apo për një çokolatë? Përse?
- A do të ishit të gatshëm të bojkotoni, diçka që ju pëlqen me të vërtetë, po qe se kjo gjë do të ndihmonte realizimin e të drejtave njerëzore të punëtorëve në vendet tjera? Përse?

Grupet paraqesin qëndrimet e tyre me karakter të përgjithshëm, kurse udhëheqësi/ja kërkon nga ata, të theksojnë arsyet më të rëndësishme që janë cekur.

Më pas u'a ndan kopjen e Listës punuese: Informatat mbi patikat dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë informatat dhe të nënvizojnë pyetjet që i kanë lidhur me informacionet. Udhëheqësi/ja sqaron, se shumë njerëz janë të brengosur për të drejtat e njeriut dhe udhëheqin fushatë kundër kompanive, të cilat punëtorët i trajtojnë në këtë mënyrë.

Diskutimi vazhdon lidhur me çështjet në vijim:

- Për herë të fundit, sa keni paguar një palë patika dhe sa të holla ka fituar personi që i ka

- bërë ato patika, në krahasim me kompaninë apo firmën që i shet.
- Cili ka qenë reagimi i tyre spontan në këtë informatë.
- Cili është mendimi i tyre për kompaninë në fjalë?
- A mendojnë se kompanitë nuk respektojnë apo thyejnë të drejtat e njeriut? Përse dhe si?
- Çka mund të bëjnë ata, si konsumatorë?

Grupet paraqesin qëndrimet e tyre, kurse udhëheqësi/ja nënvizon idetë kyçe lidhur me atë, se çka mund të bëjnë ata si konsumatorë. Në fund nxënësve/eve u ndahet dhe më pas diskutohet teksti mbi mënyrat, me anë të të cilave mund t'u tregohet kompanive multinacionale, se konsumatorët bregosen për të drejtat e punëtorëve.

IDE PËR AKTIVITETE VIJUESE:

- Nxënësit në grup shqyrtojnë , çka do të donin të bënin duke marrë parasyshë atë që kanë mësuar , e më pas shkruajnë letër, tekst të shkurtër gazetaresk, bëjnë poster apo shkruajnë një vjershë në të cilën shprehin brengën e tyre.

Materialet punuese

FAKTE MBI PUNËTORËT, QË PRODHOJNË PATIKA NË INDONEZI

Punëtorët në fabrika në Indonezi çdo muaj marrin rreth 42 Euro.
Punëtorët nuk mund të jetojnë me fëmijët e tyre, por duhet, që ata ti lënë te të afërmit në fshatrat prej nga vijnë dhe ti shohin një herë në muaj apo më rrallë.

Punëtorët janë helmuar nga ngjitësi helmues dhe preparatet tjera, që shfrytëzohen në prodhimin e këpucëve.

Punëtorët shpesh punojnë 60-70 orë në javë dhe i dënojnë, nëse nuk e plotësojnë normën e cila është aq e lartë dhe praktikisht e pamundur për t'u arritur.

Rastet aksidentale janë të zakonshme.

Keqpërdorimi verbal, fizik dhe seksual, poashtu është i zakonshëm.


Punëtorëve nuk u lejohet të bashkohen në sindikate, dhe kërcënohen nëse tentojnë të organizohen.

Kompanitë realizojnë profit enorm dhe kanë mundësi t'u japin paga të volitshme dhe kushte për punë në fabrika.



CILI ËSHTE ÇMIMI I VËRTETË PËR NJË PALË PATIKA?

- Struktura e çmimit të patikave që kushtojnë 100 euro, të cilat janë prodhuar në Indonezi



Sa kanë kushtuar patikat, që i keni blerë herën e fundit?

Shihni përqindjet afër skicës dhe llogaritni, sa është paguar punëtori, që i ka punuar ato patika?

Web faqet

Ekzistojnë shumë grupe, të cilat punojnë dhe udhëheqin fushata për të drejtat e punëtorëve dhe prodhuesve, apo për mbrojtjen e rrethit. Ata shpesh kanë web faqet e tyre, në të cilat arsimtarët dhe nxënësit kanë mundësi të informohen për temat, që i konsiderojnë interesante. Do të duhej të shihnit web faqet:

Babz milk Action Campaign

www.rionraonline.org

www.bebz milkaction.org

Trainers

www.cleanclothes.org

www.caa.org.au

www.trocaire.org

Bananas

www.bananalink.org.uk

Fair Trade

www.fairtrade.net

Tekst

ÇKA MUND TË BËJNË KONSUMATORËT?

Ekzistojnë mënyra të ndryshme, me anë të të cilave mund t'u tregohet kompanive multinacionale, se konsumatorët brengosen për të drejtat e punëtorëve, të cilët prodhojnë gjërat që blejmë.

Kini më tepër njohuri

Shfrytëzoni internetin për të fituar më tepër njohuri lidhur me kushtet, në të cilat punëtorët punojnë dhe për fushatat e udhëhequra lidhur me këtë. Lista e web.faqeve është dhënë në vazhdim.

Pyetni para se të bleni

Firmat që shesin mall, duan të fitojnë. Nëse një numër i madh njerëzish pyet psh. Ku janë prodhuar patikat dhe a janë paguar punëtorët në mënyrë të ndershme për punën e tyre, atëherë tregtarët d'o të kujdesen më tepër për këtë problem.

Proklamoni ndjenjat tuaja

Në disa raste, punëtorët nga vendet e varfëra, nuk duan që blerësit të bojkotojnë kompanitë, sepse munden të mbeten pa punë. Në vend të bojkotimit, njerëzit nxiten të blejnë etiketa/brende për të cilat kanë nevojë por gjithashtu t'i shkruajnë kompanisë, që si konsumatorë duan të sigurohen, se kushtet në të cilat punëtorët punojnë në fabrikat e tyre janë të volitshme, që punëtorët janë të paguar mjaftueshëm sa për të jetuar një jetë normale dhe se kushtet në të cilat punohet në fabrikë janë të mbikqyrura nga ana e kontrolluesit të pamvarun. Në këtë mënyrë, konsumatorët që blejnë mallin e tyre, dërgojnë mesazh të fuqishëm për t'u kujdesur më tepër për të drejtat e punëtorëve.

Bojkotimi

Mund të bojkotoni prodhimet e firmës, tek e cila dëshironi të ndikoni. A ndikon bojkoti në këtë? Po, posaçërisht nëse e lajmëroni kompaninë se po i bojkotoni prodhimet e tyre dhe cekni shkakun përse. Shembujt e forcës së bojkotimit gjenden në web faqet e cekura.

Bleni prodhime nga fer shërbimi (Fair Trade)

Duke blerë prodhime, që kanë shenjën fair trade (fer shërbimi) keni garancion, se punëtorët janë paguar sipas çmimit të drejtë për punën e tyre apo për të mirat që i kanë prodhuar dhe se kushtet, në të cilat punojnë janë të mira. Kafeja dhe çaji me shenjën **Fair Trade** janë qasëse në shumë supermarketë. Kjo vlen edhe për prodhimet tjera.

5 Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve

Pjesa dërmuese e kësaj lëmie është mbuluar nga programi i punëtorive nga edukata qytetare për vitin e parë të shkollës së mesme.

5.1 Kompetenca interkulturore

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturore – Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Psikologji, Kushtetutë dhe e drejta qytetare, Sociologji, Edukatë qytetare, Ora e kujdestarisë
Materiali	Post-it letra, (Poster me katër lloje të kompetencave interkulturore
Qëllimi	që nxënësit/et të njohtohen me 4 llojet e kompetencave, të cilat u nevojiten qytetarëve për të jetuar në një shoqëri multikulturore, demokratike.

Hapat

1. Furtunë ideshë (15')

Në grupe të vogla nxënësit/et shfletojnë dhe përshkruajnë (mund të shfrytëzohen edhe post-it letra) kompetencat e nevojshme për një jetë në një shoqëri multikulturore, demokratike. Më pas diskutojnë propozimet e shfletuara dhe i grupizojnë sipas ngjashmërisë.

2. Prezentimi dhe kategorizimi i kompetencave interkulturore (20')

Nxënësit/et paraqesin kompetencat, deri te të cilat kanë ardhur në grupe të vogla, kurse udhëheqësi/ja i shkruan në një rën nga katër kolonat (mbështetësi për kategorizim është teksti mbi kompetencat interkulturore).

3. Përmbledhja - shkruajtja e definicioneve të kompetencave interkulturore

IDE TË PËR AKTIVITETET PËRCJELLËSE:

- Nxënësit/et sëbashku kërkojnë dhe përgatisin pyetjet e më pas organizojnë kuizin " Të gjitha kulturat tona".

Teksti

Kompetenca interkulturore

Është aftësi për të njohur dhe shfrytëzuar dallimet kulturore, si një nga resurset për mësim dhe zhvillim personal.

Elementet kyçe:

1. vetëdija mbi veten, si qenie komplekse kulturore
2. vetëdija mbi ndikimin, të cilin kultura që i përkasim e kryen ndaj opinionit dhe sjelljes sonë.
3. aftësia, që së bashku me të tjerët të angazhohemi në kërkimin e supozimeve të heshtura, të cilat ndikojnë në sjelljen tonë.
4. transparenca për të testuar këndvështrimet e ndryshme në botë, mënyrat e të menduarit dhe zgjidhjes së problemeve.

5.2 Multiperspektiva / „Vizita e parë në kulturën Albatros“

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturorë – Doracak për trajnim (Grupi MOST)</i>
Kohëzgjatja	90 minuta
Lënda(ët)	Edukatë qytetare; Psikologji; Kushtetuta dhe e drejta civile; Sociologji
Materiali	Gota , Ujë dhe një copë bukë

Qëllimi që nxënësit/et të nxëjnë përvojë gjatë takimit me kulturën, vlerat normat dhe format e sjelljes së të cilës nuk i njohin dhe të shohin menyrat e ndryshme të reagimit dhe daljes nga situatat e tilla, përmes ushtrimit/simulimit „Vizita e parë në kulturën albatros“.

Hapat

1. Hyrje – Teza për përdorimin e simulimit (10')

Nxënësit/et duhet të paramendojnë një grup turistësh në udhëtim në Albatros, një vend ekzotik, në të cilin nuk kanë qenë kurrë më parë.

Situata 1: Rrugës për në kryeqytet është prishur autobusi dhe ata të lodhur me orë të tëra, të etur dhe të uritur e si duket edhe të harruar, ulen në një livadh përkaj rrugës. Nga një pyll aty afër, në drejtimin e tyre vie një vajzë. Në një distancë prej dy metrave, vajza papritmas ndalet dhe bën me dorë, duke bërë titur me zë, sikur donte t'i thërriste për t'u nisur pas saj (udhëheqësja e luan këtë rol). Ata që ishin më të etur ngriten menjëherë, të gatshëm për t'i shkuar pas vajzës, e cila qetë dhe pa e kthyer kokën pas, niset në drejtim të pyllit. Të tjerët në fillim ngurojnë dhe më pas edhe përkaj kundërshtimit të fuqishëm të grupit të vogël të mbetur, vendosin të nisen pas tyre. Rruga i shpie nëpër pyll drejt fshatit, kurse afër shtëpis! ë së parë qëndron vajza e njejtë duke bërë me dorë dhe duke folur diçka me zë të lartë. Në grupe të vogla, ju arrini deri te shtëpia.

Nxënësit/et ndahen në dy grupe (grupin më të madh e përbëjnë turistët, kurse grupin më të vogël pjestarët e albatros kulturës), njëri grup mbetet në dhomë, kurse tjetri jashtë dhe ashtu të ndarë marrin udhëzime të veçanta për të punuar mëtutje.

Vërejtje: Nëse dikush don të merr pjesë, mund ta luajë rolin e gazetarit, i cili do të informon lidhur me këtë takim të pazakontë.

2. Detyrë për nxënësit/et (10-15')

Turistët (në korridor apo në ndonjë dhomë tjetër)- udhëheqësja u sqaron nxënësve/eve, se së shpejti do të jenë mysafirë tek një familje Albatros, që nuk dijnë asgjë për normat dhe traditat e kësaj kulture, nuk e njohin gjuhën e tyre, por edhe nikoqirët nuk i kuptojnë këta. Pra, nuk e dijnë çka i pret atje, por pas gjithë kësaj janë shumë të etur dhe lodhur aq shumë, sa që me vështirësi lëvizin.

Kultura Albatros (në dhomë) – nxënësit/et ulen në rreth, por në atë mënyrë që djemtë ulen në karrige, kurse vajzat në tokë (ulen këmbëzbathur). Në mes qëndron tavolina me një bokall ujë, gota dhe bukë.

- U thuhet, se kultura albatros, është një kulturë mjaft e qetë, e përzemërt dhe mikëpritëse, por rreptësisht rituale (në të gjithë duhet të zhvillohet sipas rregullit të përcaktuara) dhe me këtë rast shfrytëzon vetëm tri mënyra për t'u shprehur (nuk përdorin fjalë, por vetëm tinguj):
 - 1) „Aaaaa!“ = për të mohuar (të paralajmërojnë në sjelljet jokorekte)
 - 2) „Ssssssss!!!“ = për lejim (të vërtetojnë sjelljen korekte)
 - 3) Kërcitja me gjuhë = Për të kërkuar diçka të bëhet

- Rituale që duhet respektuar domosdo

Rendi i vendosjes – Gruaja, kryefamiljarja, u jep shenjë mysafirëve ku të ulen: gratë ulen në tokë dhe duhet t'i zbathin këpucët, kurse meshkujt ulen nëpër karrige.

Përsëritja:

– Meshkujt përsëriten vetëm burrat, ashtu që ngriten, u japin shenjë meshkujve tjerë, që edhe ata të ngriten e më pas të gjithë njëkohësisht rrapullojnë me duar në pjesët e kofshëve.

- Gratë përshëndesin vetëm gratë, ashtu që ngriten, i japin shenjë mysafireve një nga një të ngriten, i ofrohen secilës dhe me duart e tyre prekin këmbët e tyre.

Pirja e ujit – Gruaja, si kryefamiljare, shkon për rrotull dhe jep ujë, në atë mënyrë, që grave u jep gotën me ujë për ta pirë vetë, kurse meshkujt i ngopë me ujë duke e mbajtur gotën tërë kohën në duart e saja.

Ngrënia e bukës - Gruaja, si kryefamiljare, shkon për rrotull dhe jep bukë, ashtu që grave u'a ndan copat e bukës dhe u'a jep në dorë, kurse meshkujt i ushqen me bukë nga dora e saj.

3. Aktrimi i takimit të parë (30')

Skena e albatros familjes është vendosur në dhomë, ku hyjnë turistët në grupe (2 deri 4).

Kultura albatros kujdeset, që asnjëri prej mysafirëve mos t'i thyejë rregullat (njëkohësisht të gjithë kërcasin zëshëm me gjuhë apo bërtasin „Aaaaa“) dhe me radhë luajnë ritualet një pas një: renditjen në dhomë, më pas përshëndetjen dhe më në fund japin ujë.

4. Reflektimi(15-25')

Në grupin e madh, së pari nxënësit/et, që kanë luajtur rolin e turistëve flasin për përshtypjet dhe dilemat që i kanë përjetuar. Udhëheqësi/ja i pyet çkau ka pëlqyer më shumë e çka më pak tek Kultura Albatros? Pastaj, nxënësit/et, që kanë luajtur rolin e Albatrosit flasin për përshtypjet dhe sqarojnë dilemat. Udhëheqësi/ja i pyet çka u ka pëlqyer më shumë e çka më pak tek kultura e Turistëve.

N ë fund udhëheqësi/ja përmbledh fenomenet e vërejtura dhe i lidh me

a) 5 dimensionet kulturore (të shihet teksti Modeli i Hofstdeut) dhe

b) mënyrat, me të cilat disa prej nxënësve/eve kanë reaguuar gjatë takimit me kulturën e panjohur (të shihet pjesa tjetër).

IDE PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et në ekip gjurmojnë dhe përgatitnin prezantimin e ndonjë pjese të nxjerrur nga veprat letrare, udhëpërshkrimet etj, në të cilat përshkruhen takimet e kulturave të ndryshme (orët e gjuhës dhe letërsisë serbe, gjeografisë, historisë etj.).
- Nxënësit/et në ekip gjurmojnë filmat e njohur artistik dhe dokumentarë (psh. Ato krijesa të mrekullkullueshme, Buda i vogël etj), në të cilët përshkruhen takimet e kulturave të ndryshme dhe mënyrat, se si ata e kuptojnë zhvillimin shoqërorë dhe jetën në bashkësi (orët e sociologjisë, historisë, gjeografisë etj).

MODELI I DIMENSIONEVE KULTURORE I GEERT HOFSTED-IT

Hofstedi ka identifikuar 5 dimensione, në të cilat mund të futen të gjitha dallimet kulturore:

Distanca e fuqisë - mes të pjesëtarëve të një kulture (*Power distance*) – paraqet shkallën, në të cilën ndonjë shoqëri pranon ekzistimin e ndarjes së pabarabartë të fuqisë ndërmjet individëve, distanca fuqia flet për shkallën e hierarkisë. Për shembull, flet për atë se, cila është mënyra normale e **sjelljes së vendimeve** në ndonjë organizatë apo institucion, gjegjësisht a është e zakonshme që me rastin e sjelljes së ndonjë vendimi, të gjithë të paraqesin mendimet e tyre, apo është plotësisht e pranueshme, që vendimin ta sjellë vetëm një person (kryetari/ja)

Ikja nga pasiguria (Uncertainty avoidance) – tregon shkallën, në të cilën ndonjë shoqëri tregon mosbesim ndaj gjendjeve të pasigurta 9të papërcaktuara, dyshimta) dhe tenton t'u ikë duke sjellur rregulla, të cilat garantojnë siguri. Ikja nga pasiguria flet për shkallën e pranueshmërisë së rrezikut dhe improvizimit. Për shembull në çfarë mase, ndonjë ekip do të planifikojëaktivitetet e veta dhe sa hapsirë do të mbetet për improvizim.

Individualizmi / kolektivizmi – tregon shkallën, në të cilën ndonjë shoqëri është e orientuar për të mirën e bashkësisë apo individi (anëtari/ja e familjes së ngushtë) veç e veç. Në kulturat kolektive njerëzit ndjejnë lidhje të fortë mes veti dhe përgjegjësi për secilin anëtarë/e të kulturës. Nisur nga kjo, sjellja fillimisht është e drejtuar për të mirën e tërë bashkësisë, e jo për të mirën e tij apo të familjes së tij të ngushtë, siç është rasti në kulturat individualistike.

Maskulizmi / Feminizmi – tregon shkallën, në të cilën në ndonjë shoqëri gjinia përcakton cilat do të jenë rolet e meshkujve dhe femrave në situata të ndryshme. Për shembull, cila është mënyra e zakonshme e ndarjes së punëve me rastin e ndonjë feste familjare, gjegjësisht a ekziston „ndarja e natyrshme e punëve të shtëpisë” (nënkuptohet çka do të punojnë gratë, e çka burrat) apo pritet që punët e shtëpisë t'i kryejnë të gjithë së bashku.

Orientimi kohorë (*Time orientation*) – paraqet shkallën, në të cilën ndonjë shoqëri bazon vendimet e saja në të kaluarën, të tashmen apo të ardhmen. Për shembull, vendimi lidhur me atë, se si do të duket kremtimi i ndonjë feste sillet parimisht në bazë të traditës dhe ngjarjes në të kaluarën, apo në bazë të rrethanave momentale dhe dobive afatshkurtëra, apo në bazë të asaj , që supozojmë se sjell dobi afatgjate, gjegjësisht çka e shohim se është më e mmirë për të ardhmen.

5.3 Katër reagime në takimin e kulturave të ndryshme

<i>Burimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturore – doracak për trajnim (Grupi Most)</i>
Kohëzgjatja	45 minuta
Lënda(ët)	Edukata qytetare; Psikologji; Kushtetuta dhe e drejta qytetare; Sociologji, Ora e bashkësisë së klasës
Materiali	RM
Qëllimi	Që pjesëmarrësit të dallojnë katër rrjedha themelore të takimit të kulturave të ndryshme dhe të kuptojnë konceptin bashkëkohorë të integritit.

Hapat

1. Prezantimi(15')

Udhëheqësi/ja shkurtimisht paraqet 4 rrjedhat themelore të takimit të kulturave të ndryshme (sipas Berit): asimilimin/adaptimin, marginalizimin, separacionin dhe integrimin.

Udhëheqësi/ja në mënyrë koncize sqaron paqartësitë dhe dilemat të cilat i paraqesin nxënësit/et. Disa çështje mund të mbeten të hapura (shkruhen në FC të veçantë – Çështje për të menduar).

2. Diskutimi (30')

Udhëheqësi/ja nxit pjesëmarrësit/et të njohin reaksionet e tyre tipike gjatë takimit me kulturën e re, së pari përmes reflektimit në ushtrimin paraprak (të shfrytëzohet edhe materiali punues) e më pas edhe përmes reflektimit në përvojën e deritashme jetësore (shkëmbimi i rrëfimeve dhe përjetimeve personale).

Udhëheqësi/ja mund të hap diskutimin lidhur me ate, se cilat kultura te ne janë asimiluar, marginalizuar, integruar , e cilat separohen (vetë ndahen) apo refuzohen (segregacioni). Në fund nga nxënësit/et mund të kërkojë, duke pasur parasysh tërë botën, të sjellin shembuj për secilën nga katër rrjedhat gjatë takimit të kulturave të ndryshme.

Ide për aktivitetet vijuese:

- Nxënësit/et në ekipe të vogla gjurmojnë dhe paraqesin kulturat, të cilat janë asimiluar apo marginalizuar tek ne dhe në botë (shembull kulturat e popujve të vjetër siç janë Maje, Astekët, Indianët e Amerikës veriore, Eskimët Grendlandez etj).

Materiali punues

„Vizita e parë në kulturën Albatros“

Çka dihet për kulturën Albatros?

- Në kulturën albatros toka konsiderohet e shenjtë. Në hierarkinë e tyre shoqërore gruaja është mbi burrin, kështu që vetëm femrave u lejohet të prekin tokën këmbëzbathur. Shikuar nga ky aspekt, edhe gratë janë të shenjta. Meshkujt nuk guxojnë drejtpërdrejtë të prekin asgjë që vjen nga toka, kështu që ujin dhe ushqimin nuk guxojnë ta prekin vetë por mund ta marrin vetëm nga duarte grave.
- Simbollet e hierarkisë janë të kundërta me ato europiane

Në Europë më e vlefshme është ajo që është lart / në pozitë

Në Albatros më e vlefshme është ajo që është poshtë/më afër tokës së shenjtë

Ky është shkaku përse shumica e pjesëmarrësve/eve në këtë ushtrim përjeton „perceptim të shtrembëruar“, gjegjësisht në mënyrë automatike supozon, se gratë në kulturën albatros janë të mvarura apo të diskriminuara.

Teksti

KATËR REAGIME NË TAKIMIN E KULTURAVE TË NDRYSHME

Kur individi apo grupi që i përket trashëgimisë së caktuar kulturore ndodhet në ndonjë rreth të ri, të ndryshëm kulturorë mund të reagojnë në mënyra të ndryshme, e kjo do të varet nga shkalla, në të cilën ndodhen ata

- të gatshëm dhe që kanë mundësi për të vënë kontakt me pjesëtarët e kulturave tjera, marrin pjesë në aktivitetet e tyre dhe i kuptojnë veçoritë e kulturës së re.
- kanë vullnet dhe janë të aftë të ruajnë traditat dhe karakteristikat e kulturës së personale (gjuhën, religjionin, ushqimin, mënyrën se si vishen etj).

		Vullneti dhe aftësia, për të ruajtur traditat dhe karakteristikat e kulturës personale.	
		-	+
Gatitshmëria e lartë dhe mundësia për të rënë në kontakt me pjesëtarët e kulturave tjera.	-	MARGJINALIZIMI	SEPARACIONI / SEGREGACIONI
	+	ASIMILIMI	INTEGRIMI

Asimilimi është **adaptim** i plotë në kulturën e re, gjegjësisht pranimi dhe praktikimi i vlerave dhe sjelljeve të kulturave tjera, duke anashkaluar trashëgiminë personale kulturore.

Separacioni është shmangie apo pamundësi për të vendosur kontakte me pjesëtarët e kulturave tjera, gjegjësisht ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë personale kulturore.

Margjinalizimi është humbja e lidhjeve me kulturën personale dhe njëkohësisht vendosja e pasuksesëshme e lidhjeve me kulturat tjera.

Integrimi jështë vënie e suksesëshme e kontakteve dhe kyçja active në kulturën tjetër, duke e ruajtur trashëgiminjë personale kulturore.

5.4 Decentrimi / „Vizita e dytë në kulturën Albatros“

<i>Burimi</i>	<i>Arsimimi dhe mirëkuptimi interkulturorë – doracak për trajnim (grupi Most)</i>
Kohëzgjatja	90 minuta (2 orë mësimore)
Lënda(ët)	Edukata qytetare; Psikologji; Kushtetuta dhe e drejta qytetare; Sociologji, Ora e bashkësisë së klasës
Materiali	RM
Qëllimi	Që nxënësit/et të shohin nevojën e decentrimit në rrethin multikulturorë dhe të arrijnë përvojën e integritit të formave të ndryshme kulturore dhe këndvështrimit në botë, përmes vazhdimit të ushtrimit/simulimit „Vizita e dytë në kulturën Albatros“.

Hapat

1. Hyrje- Teza për nevojat e vazhdimit të simulimit (5')

Nxënësit/et duhet të paramendojnë, se pas një viti u është dhënë rasti, për të shkuar në një vizitë tjetër në kulturën Albatros, por këtë herë me një mision, që së bashku me ta të tentojnë të zgjidhin problemin e paraqitjes së shpeshtë të sëmundjeve tek fëmijët (vdekshmëria e lartë) dhe të sjellin vendimin mbi masën e parë, që duhet ndërmarrë.

Situata 2: në Albatros kulturë fëmijët zënë një vend të posaçëm, dhe në masën që është e mundur, trajtim të barabartë me të rriturit. Mirëpo, fëmijëve u duhet shumë kohë për të zhvilluar sistemin imunologjik dhe të bëhen imun ndaj ushqimit (pemëve, perimeve etj), të cilat sipas traditës, të gjithë i hanë pa larë. Për këtë arsye ata shpesh fitojnë infeksione të barkut, të cilat për shkak të mungesës së tretmanit ndonjëherë përfundojnë edhe me vdekje.

Nxënësit/et ndahen në tri grupe (2 grupe misionarësh dhe një grup Albatros kultura), e nëse dikush nuk dëshiron të merr pjesë, mund ta merr rolin e gazetarit, i cili do të raporton lidhur me këtë takim të pazakontë.

2. Detyrë për pjesëmarrësit/et (10')

Nxënësit/et në grupe të ndara marrin udhëzime shtesë (të shihet materiali punues), të cilave duhet t'u përmbahen gjatë vazhdimit të ushtrimit (u ndahet përshkrimi i roleve të tyre). Në grupe të vogla nxënësit/et së bashku mësojnë udhëzimet dhe merren vesh për shfaqjen e tyre në mbledhje me grupet tjera.

3. Aktrimi i takimit të dytë (40') – Teknika akuarium (skena) – nga dy persona prej secilit grup gjenden në brendinë e rrethit, anëtarët/et tjerë janë në rrethin e jashtëm menjëherë pas tyre.

Udhëheqësi/ja lejon që biseda në mes të 3 grupeve të zhvillohet dhe kur të vie deri te moskuptimi më i madh, udhëheqësja ndalon skenën.

- Qarkullimi i roleve (1) – grupet i ndrojnë pozitat, ashtu që lëvizin për një vend në të djathtë. I fitojnë nga 5 minuta për decentrim në rolin e mëparshëm dhe udhëzohen në rolin e ri (lexojnë udhëzime të veçanta për atë grup). Më pas biseda vazhdon aty ku ka mbetur.

- Qarkullimi i roleve (2) – tërë procedura e ndrrimit të pozitive (lëvizja për një vend në të djathtë) dhe përgatitja dhe vazhdimi i bisedës përsëritet edhe një herë.

Në fund të ushtrimit, nxënësit/et në grupe të vogla, propozojnë zgjidhje për problemin e dhënë, të cilin në grupin e madh e shkëmbejnë dhe eventualisht e vlerësojnë, në çfarë shkalle janë ato integruese (u japin rëndësi karakteristikave të të gjitha kulturave).

4. Reflektimi (30')

Në grupin e madh, së pari nxënësit që kanë luajtur rolin e Misionarëve flasin për përshtypjet dhe dilemat që i kanë përjetuar. Pastaj, nxënësit/et që kanë luajtur rolin e Albatros kulturës, flasin për përshtypjet dhe dilemat e tyre.

Udhëheqësi/ja nxit pjesëmarrësit të tregojnë, se çka i ka shtyrë të propozojnë zgjidhjet e dhëna dhe momentet në vetë ushtrimin, të cilat i kanë kontribuar sjelljes së një vendimi të tillë.

Udhëheqësi/ja shkurtimisht paraqet termin decentrim, duke demonstruar kuptimin dhe rëndësinë e tij (si ndryshimet e këndvështrimit) për fitimin e një pasqyre lidhur me ndonjë dukuri apo ngjarje.

Për shembull: udhëheqësja vendos në mes të rrethit ndonjë send i cili nga të katër anët ka ngjyrë të ndryshme dhe kërkon nga nxënësit/et të tregojnë çfarë ngjyre ka ai send. Pastaj, i pyet pjesëmarrësit/et çka është dashur të bëjnë për t'u përgjigjur saktë në pyetjen e parashtruar – dhe në këtë mënyrë e sjell termin e decentrimit.

Më pas udhëheqësi/ja nxit pjesëmarrësit/et të njohin dhe paraqesin përvojën e tyre lidhur me decentrimin (reflektimi në ushtrimin paraprak dhe në përvojën reale jetësore). Në fund, nxënësve u ndahet **Teksti** mbi decentrimin.

IDETË PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et në ekip përgatisin rrëfim të shkurtër të ndonjë vepre letrare apo ngjarje të njohur, por në atë mënyrë që të shihet nga këndvështrimi i ndonjë personaliteti „negativ” apo „sekondar”.

Materiali punues

„Vizita e dytë në kulturën albatros”

Detyra për pjesëmarrësit/et:

- **Misionarët 1** – ju jeni një grup ekspertësh për arsimim nga Europa dhe ju mendoni se:
 - duke i trajnuar të rriturit dhe fëmijët lidhur me rëndësinë e mbajtjes së higjienës së përgjithëshme dhe higjienës në të ushqyer ky problem mund të zgjidhet më së lehti (çka të vendoset)
 - që për këtë problem, fillimisht duhet të pyeten dhe për të të vendosin njerëzit më profesional për këtë lëmi (si të vendoset)
 - me rastin e sjelljes së vendimit, për masën e parë që do ta ndërmerrni duhet menduar një kohë të gjatë, gjegjësisht të ndërmerret diçka, që në të ardhmen në mënyrë afatgjate të zgjidhë këtë problem. (përse)
- **Misionarët 2** – ju jeni një grup ekspertësh shëndetësorë nga SHBA dhe mendoni se:
 - me anë të përforcimit të mbrojtjes shëndetësore (hapja e ambulancave, mjekët pa kufij) dhe preventivës (vaksinimit sistematik të fëmijëve dhe të rriturve) këtë problem ta zgjidhni shpejt dhe padhimbshëm (çka të vendoset).
 - që për këtë problem, pasi që situata është mjaft kritike dhe kërkon reagim të shpejtë, vendimin përfundimtarë duhet ta sjellin personat më përgjegjës, gjegjësisht udhëheqësit e misioneve dhe kryepleqtë e fshatrave (si të vendoset)
 - me rastin e sjelljes së vendimit, për masën e parë që do ta ndërmerrni duhet menduar në afat të shkurtër, gjegjësisht çka të ndërmerret që problemi të zgjidhet menjëherë. (përse).

- **Kultura Albatros** – ju nuk e shihni, që vdekja si e tillë paraqet ndonjë problem (sepse besoni që njerëzit nuk vdesin, por vetëm e ndërrojnë formën e të ekzistuarit). Prapëseprapë, sëmundja është diçka që ju brengosë edhe juve, kështu që mendoni se:
 - ushqimi hahet ashtu si është dhënë nga Zoti dhe se Ai do të kujdeset të zgjidhë këtë problem nëse dduhet dhe kur duhet (çka të vendoset).
 - për këtë problem duhet të pyeten të gjithë anëtarët e bashkësisë së fshatit, e posaçërisht fëmijët (si të vendoset)
 - me rastin e sjelljes së vendimit lidhur me masën e parë që do të ndërmerri të mendoni për traditën personale dhe përvojat e ngjashme në të kaluarën, prej nga rrjedh se nuk ka vend për t'u ngutur (përse)

DECENTRIMI

Është e natyrshme dhe e arsyeshme, që së pari gjërat dhe dukuritë t'i shohim nga këndvështrimi jonë. Mirëpo, këtë e bëjnë edhe njerëzit tjerë- kështu që ajo që shihet nga këndvështrime të ndryshme shpesh është e papajtueshme. Të decentrosh don të thotë të mundohesh, që nga këndvështrimi huaj, për ne i pazakonshëm dhe i panjohur, të të vrojtohet ndonjë situatë, në mënyrë që më mirë të kuptojmë gjendjen dhe veprimet e të tjerëve dhe të jemi në gjendje të reagojmë në mënyrë më të matur.

Mposhtja e egocentrizmit (apo etnocentrizmit) gjatë vrojtimit të dukurive, gjegjësisht mbështetjes jokritike posaçërisht në shqisat, vlerat dhe standardet tona, është process i rëndësishëm për zhvillimin e individit dhe shoqërisë në tërësi. Shoqëritë/kulturat dallohen dukshëm edhe sipas asaj , se çfarë akcenti i vejnë përdorimit të decentrimit gjatë rritjes, shkollimit, kryerjes së punëve, komunikimit të përditshëm etj. Për fat të keq, në kulturën tone qasjet e tilla janë shumë të rralla dhe të zbehta.

Decentrimi nuk është veprim i lehtë, gjegjësisht është shumë vështirë:

- të kuptohet ,se dikush tjetër, në mënyrë të sigurtë dhe me bindje të plotë të mendojë dhe shohë ndryshe nga ne situatën e njejtë.
- të kuptohet , se edhe këndvështrimi i huaj varet nga lloji i informatës në të cilën ndërtohet, pikërisht si këndvështrimi jonë.
- të pranohen ndjenjat e huaja si reale dhe legjitime, bile edhe nëse janë të ndryshme nga tonat edhe pse u frikësohemi
- të vazhdohet me decentrimin, bile edhe atëherë kur kuptojmë gjëra të pakëndshme për ne dhe veprimet tona.

Gjatë decentrimit do t'a keni më lehtë nëse:

- përkujtoni përvojat që i përcjell kuptimi i ndonjë risie, ndonjë të papriture-decentrimi mund t'iu sjellë një përvojë të tillë, përgatituni për këtë.
- rekonstruktioni kontekstin e personit – ndonjëherë është e dobishme të paramendohet konteksti fizik ku jeton, ku rrin, me kend takohet, çka din, çka nuk din, në bazë të çkahit....
- mos i harroni ndjenjat – edhe ato janë pjesë e kontekstit, pra si mund të ndjehet dikush që jeton ashtu, din për këtë...
- mos mendoni vetëm për ate, se çka do të bënit ju po të ishit në vendin e tij/saj, por për ate se çka do të duhej të ndodhte dhe ju të bënit të njejtën gjë që e ka bërë ai/ajo.
- lejoni që procesi i decentrimit të rrjedhë- revidoni kontekstin e imagjinuar, edhe të jashtëmin edhe të brendshmin, disa herë, deri sa të ndjeni se keni zbuluar rrethana, në të cilat veprimet problematike të personit të duken plotësisht të logjikshme dhe të arsyeshme.
- në bazë të një konteksti të tillë të reviduar të personit tjetër, hidhni shikim edhe vetes dhe veprimeve tuaja, shihni si veprojnë ato tek ai/ajo.
- në bazë të një konteksti të tillë të reviduar, parashikoni veprimet e mëtejme të personit, posaçërisht ato veprime, që për ju janë më të rëndësishme.

Decentrimi nuk është:

- arsyetim, sepse të kuptosh nuk don të thotë të pranosh si të drejtë
- interpretim, por sjell njohuri të reja
- mjet për sulm, rrugë për mirëkuptim.

5.5 Dialogu interkulturore

Burimi Të kuptuarit dhe arsimimi interkulturore – Doracak për trajnim (Grupi MOST)

Kohëzgjatja 60 minuta

Lënda(ët) Edukatë qytetare; Psikologji; Kushtetutë dhe e drejta civile; Sociologji; Ora e bashkësisë klasore

Materiali RM

Qëllimi Që nxënësit të bëjnë dallimin ndërmjet debatit dhe dialogut (si dy forma komunikuese) dhe të vërejnë specifikat e dialogut interkulturore, përmes vazhdimit të ushtrimit/simulimit „Vizita e dytë në kulturën Albatros“

Hapat

1. Debati dhe dialogu - prezantimi (15')

Udhëheqësja/i në mënyrë koncize sqaron karakteristikat e debatit dhe dialogut ndaj Tekstit, i cili i shpërndahet të gjithë pjesëmarrësve/eve. Udhëheqësja sqaron paqartësitë dhe përgjigjet në pyetjet e pjesëmarrësve/eve.

2. Përvoja e dialogut - „Vizita e dytë në kulturën e Albatrosit “ (30')

Teza:

- Secili grup (ndarja e njejtë si në punëtorinë 5.4) merr udhëzime të ndryshme shtesë, të cilat definojnë stilin e të komunikuarit (sipas Kimit):
 - Albatrosi – drejtimi vetëm në marrëdhëniet sociale
 - Misionarët 1 – drejtimi vetëm në rrjedhën e bisedimeve
 - Misionarët 2 – drejtimi në marrëdhënie dhe rrjedhë
- Pasi që nxënësit/et në ushtrimin paraprak kanë ardhur deri te propozim për zgjidhjen e problemit për të cilin kanë biseduar, tani të ndarë në tri grupet e njejtë vazhdojnë të shqyrtojnë zgjidhjet e ofruara, me qëllim për të ardhur deri te një zgjidhje, e cila do të jetë e pranueshme për të gjitha palët.

Aktrimi:

Gjatë aktrimit, udhëheqësi/ja përdorë „prerjen“ për të ndihmuar nxënësit/et të shohin momentet, kur biseda shkon kah polemika dhe i nxit të shfrytëzojnë unë-bisedën, parafrazimin, çështjet e hapura, teknikën feedback etj në mënyrë që biseda të kalojë në dialog dhe të rezultojë me mirëkuptimin e pozitave, nevojave dhe këndvështrimeve të ndryshme në problem.

3. Reflektimi (15')

Udhëheqësi/ja nxit nxënësit/et të vlerësojnë masën, në të cilën zgjidhja deri te e cila kanë ardhur në fund është me të vërtetë e pranueshme për të gjithë dhe të vërejnë elementet e njërës dhe kulturës tjetër, të thurura në zgjidhje përfundimtare.

Udhëheqësi/ja nxit nxënësit/et të shohin, çka u ka ndihmuar gjatë bisedës e çka jo, si dhe të vijnë deri te zgjidhja, çfarë ka qenë paraqitja e grupeve të veçanta dhe me çka janë dalluar ata, duke i udhëzuar të vërejnë drejtimin e ndryshëm kulturorë të komunikimit. Nxënësit/eve u ndahet dhe shkurtimisht u sqarohet teksti mbi kufizimet e komunikimit interkulturore. (Kim).

IDE TË PËR AKTIVITETET VIJUESE:

- Nxënësit/et së bashku gjurmojnë dhe përgatisin prezantimin mbi format tipike të komunikimit dhe karakteristikat e bisedave në emisione të ndryshme televizive (psh. Përshtypja e javës, Në ndihmë, Gracka, replika, Populli pyet etj).
- Nxënësit/et në grup apo individualisht shkruajnë, apo në mënyrë tjetër paraqesin çka

nënkuptojnë për ta fjalët "dialog" dhe "kulturë"

Teksti

5 KUFIZIMET E KOMUNIKIMIT INTERKULTURORE (Kim)

Drejtimi i komunikimit dallohet nga kultura në kulturë - pa marrë parasyshë a bëhet fjalë për shoqëritë në tërësi, grupet e veçanta apo organizatat - dhe këto dallime në mënyrën e komunikimit mundën në masë të konsiderueshme të pengojnë (kufizojnë) mirëkuptimin në mes të përfaqësuesve/eve të kulturave të ndryshme.

Kim përshkruan 2 lloje themelore të drejtimeve komunikuese kulturore

A. drejtimi parimor në temë dhe rrjedhë bisede (qëllimi dhe rezultatet)

B. drejtimi parimor në marrëdhëniet sociale (ruajtja dhe ndërtimi i raporteve në mes njerëzve)

A. Kufizimet e komunikimit të drejtuara në temë dhe rrjedhë:

1. Kujdesi mbi **qartësinë e mesazheve** - gjatë bisedimeve duhet patur kujdes, që qëllimet të paraqiten qartë dhe drejtpërdrejtë
2. Kujdesi mbi **efikasitetin e bisedës** - gjatë bisedimeve duhet patur kujdes, që me anë të saj të arrihet qëllimi kryesor, gjegjësisht, që biseda të shpie deri te rrjedha e dëshiruar.

B. Kufizimet e komunikimit të drejtuara në marrëdhëniet sociale:

3. Duhet pasur kujdes, **që mos të lëndojmë ndjenjat e të tjerëve**- gjatë bisedës duhet kushtuar kujdes personit, të cilit i drejtohem dhe duhet ikur nga çdo sjellje, me të cilën do të mund të lëndohej apo prishej pasqyra pozitive e tij ndaj vetes.
4. Duhet pasur kujdes, që të tjerët mos të na **vlerësojnë në mënyrë negative**- gjatë bisedës duhet patur kujdes, se çka mendojnë të tjerët për ne dhe duhet ikur nga çdo sjellje, në bazë të së cilës të tjerët do të mund të na vlerësonin negativisht
5. Duhet pasur kujdes, që mos të **imponojmë vullnetin tonë**- gjatë bisedës duhet pasur kujdes, që mos të prishej liria e zgjedhjes dhe aksioneve tek të tjerët.

POLEMIKA

(DEBATI)

DIALOGU

QËLLIMI	QËLLIMI
SHKËMBIMI DHE ACARIMI I QËNDRIMEVE MUND TË UDHËHIQET EDHE ME QËLLIM QË TË MPOSHTET, APO TI KTHEHET MENDJA KUNDËRSHTARIT.	NDRRIMI DHE MIRËKUPITIMI / HARMONIZIMI I QËNDRIMEVE QËLLIMI ME TË CILIN UDHËHIQET MUND TË JETË DËGJIMI I NDËRSJELLË DHE MARRJA E MËSIMIT NGA TË TJERËT DUKE U KUSHTUAR RËNDËSI DALLIMEVE
TEZA / SETING	TEZA / SETING
PALËT E BALLAFAQUARA ULEN NJËRA PËRBALLË TJETRËS, ZAKONISHT ZHVILLOHET NË PRANI TË PUBLIKUT TË VËRTETË APO TË SUPOZUAR.	RADHITJA E ULJES ËSHTË NË RRETH, KONTEKSTI ËSHTË I SIGURT ZAKONISHT, DIALOGU ZHVILLOHET PA PRANINË E PUBLIKUT.
PJESËMARRËSET DHE PJESËMARRËSIT	PJESËMARRËSET DHE PJESËMARRËSIT
LIDERËT/ET ME QËNDRIME TË QARTA, NË SHUMICËN E RASTEVE PERSONAT E NJOHUR PËR OPINIONIN, TË CILËT SILLEN NË PËRPUTHJE ME STEREOTIPIN, KURSE PARAQITEN SI PËRFAQËSUES/E TË NDOJË GRUPI. PJESËMARRJA NUK NËNKUPTON PËRGATITJE PARAPRAKE DHE MARRËVESHJE RRETH RREGULLAVE, POR MUND TË LEJOHEN SULMET DHE NDËRPRERJET E BASHKËBISEDUESIT.	INDIVIDËT/ET E RËNDËSISHËM NGA NDOJË LËMI, TË CILËT NUK E KANË PATJETËR TË JENË TË NJOHUR PËR OPINIONIN, KURSE SILLEN NË PËRPUTHJE ME PERSONALITETIN E TYRE DHE PARAQITEN SI INDIVIDË. PJESËMARRJA NË DIALOG NËNKUPTON RREGULLAT E CAKTUARA PARAPRAKE, KURSE I PARAPRIJNË PËRGATITJET E GJATA DHE NË DETAJE.
QËLLIMI I BISEDËS	QËLLIMI I BISEDËS
PJESËMARRËSIT/ET I DREJTOHEN GRUPIT QË PËRFAQËSOJNË DHE SIMPATIZUESVE/EVE, GJEGJËSISHT PUBLIKUT, MË TEPËR SE NJËRI TJETRIT.	NXËNËSIT/ET SË PARI I DREJTOHEN NJËRI TJETRIT, SI DHE BASHKËBISEDUESVE PREZENT, NËSE KA NË VENDIN KU MBAHEN USHTRIMET.
KARAKTERISTIKAT E BISEDËS	KARAKTERISTIKAT E BISEDËS
<ul style="list-style-type: none"> DALLIMET NË MENDIMET E PJESËMARRËSVE DHE PJESËMARRËSEVE BRENDA ANËS SË NJEJTË MINIMALIZOHEN. DËGJOJNË NJËRI TJETRIN PËR T'U PËRGËNJESHTRUAR APO ZBULUAR MES VETE GABIMET GJATË ARGUMENTIMIT SHTROJNË PYETJE RETORIKE DHE GRACKA FLITET PËR QËNDRIMET, IDETË , ARRITJET 	<ul style="list-style-type: none"> ZBULOHEN DALLIMET NË OPINIONET E ANËTARËVE TË ANËS SË NJEJTË PJESËMARRËSIT DHE PJESËMARRËSET DËGJOJNË NJËRI TJETRIN PËR T'U KUPTUAR MË MIRË SHTROHEN PYETJE TË HAPURA NGA KURESHTJA FLITET PËR DILEMAT DHE BINDJET E THELLA.
RRJEDHA	RRJEDHA
MUNGESA E PIKËPAMJEVE TË REJA, MPREHJA E QËNDRIMIT PERSONAL, KRAHASIMI I QËNDRIMEVE TË TËRTHORTA DHE PËRJETIMEVE SE PALA KUNDËRSHTARE ËSHTË E MAJORIZUAR, HUMBUR APO KA QENË MË E SUKSESËSHME	NJOHURI DHE PIKËPAMJE TË REJA PËR TË GJITHË PJESËMARRËSIT DHE PJESËMARRËSET, GJEGJËSISHT LËVIZJE KAH NDOJË KËNDVËSHTRIM I RI NDAJ PROBLEMIT TË PARAQITUR PËR TË CILIN ËSHTË BISEDUAR.
<i>Burimi:</i> Babbitt, E., Gutlove, P. & Jones, L. (1994). <i>Handbook of Basic Conflict Resolution Skills: Facilitation, Mediation and Consensus Building.</i> Cambridge, MA	